



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-04

Prokurori k. Pjetër Shalës

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 18 tetor 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Mocionin që Ngre Kundërshtime lidhur me Themelimin dhe
Juridiksionin e Dhomave të Specializuara**

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të Pjetër Shalës

Zhan-Lui Zhilisen

PËRMBAJTJA

I.	HISTORIKU PROCEDURAL	2
II.	PARASHTRIME	3
A.	themelimi i dhomave të specializuara	5
1.	Mocioni i Mbrojtjes.....	5
2.	Përgjigjja.....	7
3.	Kundërpërgjigjja	8
B.	e drejta zakonore ndërkombëtare	10
1.	Mocioni i Mbrojtjes.....	10
2.	Përgjigjja.....	11
3.	Kundërpërgjigjja	12
C.	ndërmarrje kriminale e përbashkët	15
1.	Mocioni i Mbrojtjes.....	15
2.	Përgjigjja.....	18
3.	Kundërpërgjigjja	21
D.	Ndalimi arbitrar	22
1.	Mocioni i Mbrojtjes.....	22
2.	Përgjigjja.....	25
3.	Kundërpërgjigjja	26
III.	DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSË	27
A.	mocionet paraprake	27
B.	Themelimi i Dhomave të Specializuara	27
C.	E drejta Zakonore Ndërkombëtare.....	28
D.	Ndërmarrja Kriminale e Përbashkët	29
E.	Ndalimi Arbitrar	29
IV.	DISKUTIM	30
A.	Aspektet Paraprake.....	30
1.	Natyra e Mocionit të Mbrojtjes	30
2.	Seanca gojore.....	32
B.	Themelimi Dhomave të Specializuara	33
C.	Juridiksioni i Dhomave të Specializuara	36
1.	E Drejta Zakonore Ndërkombëtare	36
2.	Ndërmarrja Kriminale e Përbashkët.....	40
3.	Ndalimi arbitrar.....	45
V.	VENDIM.....	49

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në pajtim me nenet 22, 33(1), 103(7) dhe 162(1) të Kushtetutës së Kosovës (“Kushtetuta”), nenet 3(2), 12, 14(1)(c), 16(1)(a), dhe 39(1) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullën 97 të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), nxjerr këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 19 qershor 2020, në vijim të vendimit të lëshuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake (“Vendimi i Konfirmimit”),² Prokurori i Specializuar dorëzoi Aktakuzën e Konfirmuar.³
2. Më 16 mars 2021, në vijim të vendimit dhe fletarrestimit të lëshuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake,⁴ Pjetër Shala (“z. Shala” ose “i akuzuari”) u arrestua në Mbretërinë e Belgjikës (“Belgjikë”).⁵

¹ KSC-BC-2020-04, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 14 shkurt 2020, publik.

² KSC-BC-2020-04, F00007, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Pjetër Shalës*, 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe ex parte. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 6 maj 2021, F00007/CONF/RED dhe F00007/RED.

³ KSC-BC-2020-04, F00010, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar*, 19 qershor 2020, publik, me shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe ex parte, dhe shtojcën 2, konfidenciale. Versioni konfidencial me më pak redakte dhe versioni publik edhe me më pak redakte i Aktakuzës së Konfirmuar u dorëzuan më 31 mars 2021, F00016/A01 dhe F00016/A02.

⁴ KSC-BC-2020-04, F00008, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Lëshimin e Fletarrestimit dhe Urdhrit të Transferimit*, 12 qershor 2020, konfidencial. Versioni i redaktuar publik doli më 6 maj 2021, F00008/RED. F00008/A01, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Fletarrestim për z. Pjetër Shala*, 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe ex parte. Versioni i redaktuar publik u lëshua më 15 prill 2021, F00008/A01/RED.

⁵ KSC-BC-2020-04, F00013, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit sipas Rregullës 55(4)*, 16 mars 2021, publik.

3. Më 15 prill 2021, me përfundimin e procedurave gjyqësore në Belgjikë, z. Shala u transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara ("DHS") në Hagë, Holandë.⁶
4. Më 12 qershor 2021, në vijim të urdhrimit me gojë që miratonte zgjatjen e afateve të përcaktuara,⁷ Mbrojtja e z. Shala ("Mbrojtja") dorëzoi një mocion paraprak me anë të të cilit ngrinte kundërshtime për juridiksionin e DHS-së ("Mocioni i Mbrojtjes").⁸
5. Më 6 shtator 2021, në vijim të vendimit që shtynte më tej afatet e përcaktuara ("Vendimi i datës 5 korrik 2021") si dhe vendimit që lejonte shtimin e numrit të lejuar të fjalëve,⁹ Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") paraqiti përgjigjen e vet ("Përgjigjja").¹⁰
6. Më 24 shtator 2021, në vijim të Vendimit të datës 5 korrik 2021 si dhe urdhrimit me gojë që miratonte shtimin e numrit të lejuar të fjalëve,¹¹ Mbrojtja paraqiti kundërpërgjigjen ("Kundërpërgjigjja").¹²

II. PARASHTRIME

7. Mbrojtja parashtron se: (i) DHS-ja është themeluar si gjykatë vendore në shkelje si të Kushtetutës, po ashtu dhe të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive

⁶ KSC-BC-2020-04, F00019, Administratorja, *Njoftim për Pranimin e Pjetër Shalës në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe për Caktimin me Kusht të Mbrojtësit*, 15 prill 2021, konfidencial, para. 2, me shtojcat 1-2, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik doli më 26 prill 2021, F00019/RED.

⁷ KSC-BC-2020-04, Transkript, 21 qershor 2021, f. 62, rreshtat 12-19, publik.

⁸ KSC-BC-2020-04, F00054, Mbrojtja e Specializuar, *Mocioni Paraprak i Mbrojtjes së Pjetër Shalës që Kundërshton Juridiksionin e DHS-së*, 12 korrik 2021, publik.

⁹ KSC-BC-2020-04, F00052, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Ndryshimin e Afatit*, 5 korrik 2021, publik; F00067, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e ZPS-së për Tejkalimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve*, 3 shtator 2021, publik.

¹⁰ KSC-BC-2020-04, F00071, Prokurori i Specializuar, *Përgjigjja e Prokurorisë ndaj Mocionit Paraprak të Mbrojtjes së z. Shala që Kundërshton Juridiksionin e DHS-së*, 6 shtator 2021, publik.

¹¹ KSC-BC-2020-04, Transkript, 23 shtator 2021, f. 101, rreshti 19 – f. 102, rreshti 7, publik.

¹² KSC-BC-2020-04, F00084, Mbrojtësi i Specializuar, *Kundërpërgjigjja e Mbrojtjes ndaj Përgjigjes së Prokurorisë mbi Mocionin Paraprak të Pjetër Shalës që Kundërshton Juridiksionin e DHS-së*, 24 shtator 2021, publik. Megjithëse Kundërpërgjigjja tejkalon me 15 fjalë numrin e miratuar të fjalëve Gjykatësi i Procedurës Paraprake vendos ta pranojë në interes të efikasitetit gjyqësor.

Themelore të Njeriut (“KEDNJ”); dhe (ii) nuk ka juridiksion mbi formën e përgjegjesisë penale të Ndërmarrjes Kriminale të Përbashkët (“NKP”) dhe mbi krimin e luftës të ndalimit arbitrar në një konflikt të armatosur jondërkombëtar (“KAJN”).¹³ Mbështetur mbi këto arsye time Mbrojtja kërkon nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake që: (i) të shqyrtojë konstatimet përkatëse në Vendimin e Konfirmimit; (ii) të hedhë poshtë akuzat kundër z. Shala të ngritura për ndërmarrje kriminale të përbashkët dhe ndalim arbitrar; dhe (iii) të urdhërojë ZPS-në që të ndryshojë Aktakuzën e Konfirmuar, në përshtatje me sa më lart.¹⁴

8. ZPS-ja përgjigjet në formë përmbledhëse se: (i) DHS-ja është një organ gjyqësor kushtetues, i pavarur dhe i paanshëm, i krijuar me ligj; (ii) Ligji zbaton të drejtën zakonore ndërkombëtare në kohën e kryerjes së krimeve, në pajtueshmëri të plotë me parimet kushtetuese dhe të drejtat e njeriut; dhe (iii) e drejta zakonore ndërkombëtare konkrete ishte e disponueshme dhe e parashikueshme për të akuzuarin, edhe në lidhje me NKP-në dhe ndalimin arbitrar.¹⁵ Mbi këtë bazë, ZPS-ja kërkon nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake që të rrëzojë Mocionin e Mbrojtjes.¹⁶

9. Në kundërpërgjigjen e vet, Mbrojtja u qëndron argumenteve të paraqitura në Mocionin e Mbrojtjes si dhe kundërshton çdo parashtrim të paraqitur në Përgjigje, përveçse kur tregohet shprehimisht ndryshe.¹⁷ Mbrojtja përsërit kërkesën për miratimin e Mocionin të Mbrojtjes.¹⁸ Gjithashtu, Mbrojtja kërkon leje për të shtjelluar në një seancë gojore parashtrimet e paraqitura në Mocionin e Mbrojtjes dhe Kundërpërgjigje.¹⁹

¹³ Mocioni i Mbrojtjes, para. 2-3.

¹⁴ Mocioni i Mbrojtjes, para. 61.

¹⁵ Përgjigja, para. 1.

¹⁶ Përgjigja, para. 1, 69.

¹⁷ Kundërpërgjigja, para. 2.

¹⁸ Kundërpërgjigja, para. 49.

¹⁹ Kundërpërgjigja, para. 49.

A. THEMELIMI I DHOMAVE TË SPECIALIZUARA

1. Mocioni i Mbrojtjes

10. Mbrojtja mbështet parashtrimet e ngritura nga Mbrojtja e Kadri Veselit se DHS-ja është gjykatë vendore dhe duhet dalluar nga tribunalët ndërkombëtarë dhe hibridë, pasi *de facto* është një gjykatë e jashtëzakonshme dhe si rrjedhojë shkel nenin 103(7) të Kushtetutës.²⁰ Sipas mendimit të Mbrojtjes, aspektet vijuese manifestojnë natyrën e saj të jashtëzakonshme.

11. Së pari, Mbrojtja parashtron se Ligji përcakton se qëllimi i DHS-së është garantimi i procedurave penale të sigurta, të pavarura, të paanshme, të drejta dhe efikase në lidhje me pretendimet për krime të rënda ndërkufitare dhe ndërkombëtare të kryera gjatë konfliktit në Kosovë të paraqitura në Raportin e Dik Martit e që janë raportuar në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës (“Raporti i Këshillit të Evropës”).²¹

12. Së dyti, në lidhje me pohimin e saj se të gjithë gjykatësit, prokurorët dhe punonjësit e DHS-së janë ndërkombëtarë, Mbrojtja mbështet argumentet e ngritura nga Mbrojtja e Rexhep Selimit se struktura dhe përbërja e DHS-së bie ndesh në mënyrë flagrante me themelimin e duhur të DHS-së si gjykatë vendore duke pasur parasysh se përjashtimi i shqiptarëve të Kosovës nga punësimi ose nga çdo pjesëmarrje në DHS cenon parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit që garantohet në nenin 7 të Kushtetutës të Kosovës dhe nenet 6 dhe 14 të KEDNJ-së.²²

13. Së treti, sipas Mbrojtjes, Ligji mëton t’i japë përparësi DHS-së kundrejt të gjitha gjykatave të tjera në Kosovë dhe është interpretuar në një mënyrë të tillë që devijon thelbësisht nga Kushtetuta dhe ligje të tjera të së drejtës penale materiale të Kosovës.²³

²⁰ Mocioni i Mbrojtjes, para. 5-7 i referohen KSC-BC-2020-06, F00223, Mbrojtësi i Specializuar, *Mocioni Paraparak i Mbrojtjes së Kadri Veselit për Kundërshtimin e Juridiksionit të DHSK Bazuar në Shkelje të Kushtetutës*, 15 mars 2021, publik.

²¹ Mocioni i Mbrojtjes, para. 2, 7, 8.

²² Mocioni i Mbrojtjes, para. 2, 7, 9-11 i referohet KSC-BC-2020-06, F00219, *Mocion Paraparak për Rrëzimin e Aktakuzës për shkak të Mungesës së Juridiksionit – Diskriminim*, 15 mars 2021, publik.

²³ Mocioni i Mbrojtjes, para. 2, 7, 12.

Më tej argumentohet se neni 3(2)(d) i Ligjit që përcakton se DHS-ja gjykon dhe funksionon në përputhje me të drejtën zakonore ndërkombëtare (“DZN”), është jokushtetues.²⁴ Mbrojtja parashtron se Gjykata Supreme e Kosovës është shprehur se, në kohën që lidhet me Aktakuzën e Konfirmuar, zbatohet Kushtetuta e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë e vitit 1974 (“RSFJ” dhe “Kushtetuta e RSFJ-së”), në bazë të së cilës veprat penale duhej të përcaktoheshin me ligjet vendore.²⁵ Sipas saj, mospërputhja dhe paqartësia lidhur me dispozitat ligjore përkatëse bie ndesh me të drejtën “e parimit të ligjshmërisë” të garantuar nga neni 33 i Kushtetutës dhe neni 7(1) i KEDNJ-së.²⁶ Gjithashtu, Mbrojtja beson se neni 12 i Ligjit është jokushtetues meqenëse mëton t’i japë të drejtës zakonore ndërkombëtare përparësi mbi të drejtën penale materiale të Kosovës.²⁷ Në këtë drejtim, Mbrojtja pretendon se përmendja e gabuar e nenit 7(2) të KEDNJ-së në nenin 12 të Ligjit nuk lejon cilësimin e parimit të ligjshmërisë dhe kriterit të prapaveprueshmërisë sipas nenit 7(2) të KEDNJ-së, pasi sipas interpretimit nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (“GJEDNJ”), ai nen ishte një sqarim për një periudhë kohore të caktuar që synonte të siguronte vlefshmërinë pas Luftës së Dytë Botërore të ndjekjes penale të krimeve të luftës të kryera gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe nuk mund të zbatohet për konfliktet e mëvonshme.²⁸

14. Së fundi, Mbrojtja pretendon se mënyra si është interpretuar Ligji bie ndesh me parimin madhor të ligjshmërisë të garantuar në Kushtetutën e Kosovës dhe KEDNJ.²⁹ Më konkretisht, argumentohet se neni 14(1)(c) i Ligjit i referohet të drejtës zakonore ndërkombëtare lidhur me togfjalëshin “krime lufte”, ndërkohë që zbatimi i të drejtës zakonore ndërkombëtare duhet të kryhet në përputhje me parimin e ligjshmërisë.³⁰

²⁴ Mocioni i Mbrojtjes, para. 12.

²⁵ Mocioni i Mbrojtjes, para. 12.

²⁶ Mocioni i Mbrojtjes, para. 12.

²⁷ Mocioni i Mbrojtjes, para. 2, 13.

²⁸ Mocioni i Mbrojtjes, para.13-14.

²⁹ Mocioni i Mbrojtjes, para. 2, 7.

³⁰ Mocioni i Mbrojtjes, para. 15.

2. Përgjigjja

15. ZPS-ja pretendon se kundërshtimet e ngritura në lidhje me ligjshmërinë e DHS-së nuk përbëjnë kundërshtime juridiksionale sipas kuptimit të rregullës 97(1)(a) të Rregullores.³¹

16. Krahas kësaj, ZPS-ja është e mendimit se, ashtu sikurse ka konstatuar dhe Gjykata Kushtetuese e Kosovës më parë dhe siç e konfirmoi së fundi Gjykatësi i Procedurës Paraprake në çështjen gjyqësore KSC-BC-2020-06, DHS-ja është gjykatë e specializuar, e paanshme dhe e pavarur dhe nuk është gjykatë e jashtëzakonshme sipas kuptimit të nenit 103(7) të Kushtetutës.³² ZPS-ja shton se në kohën kur DHS-ja u shpall në përputhje me nenin 103(7) të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese e Kosovës përcaktoi qartë se legjislatura do të miratonte një ligj të posaçëm që do të rregullonte organizimin, funksionimin dhe juridiksionin e DHS-së, përfshirë dhe elemente konkrete të Ligjit për të cilat Mbrojtja kërkon rishqyrtim të konstatimeve lidhur me statusin e DHS-së.³³ ZPS-ja argumenton se në Mocionin e Mbrojtjes nuk ngrihet asnjë argument apo arsye e re për të ndryshuar këto konstatime.³⁴

17. Më tej ZPS-ja shton se edhe në rast Gjykatësi i Procedurës Paraprake do ta konsideronte të nevojshme të rishqyrtonte cilindo prej këtyre elementeve, parashtrimet e Mbrojtjes sërish nuk do të qëndronin.³⁵ Së pari, sa i takon kuadrit juridiksional, ZPS-ja argumenton se juridiksioni i DHS-së nuk kufizohet vetëm në një çështje (apo qoftë dhe domosdoshmërisht në një numër të vogël çështjesh) dhe as nuk kufizohet në një vepër penale specifike, një kryes apo qoftë dhe një kategori të caktuar kryesish.³⁶ Së dyti, sa u takon punonjësve ndërkombëtarë dhe gjyqësorit, ZPS-ja

³¹ Përgjigjja, para. 2.

³² Përgjigjja, para. 3-7.

³³ Përgjigjja, para. 9.

³⁴ Përgjigjja, para. 3, 8, 9.

³⁵ Përgjigjja, para. 9.

³⁶ Përgjigjja, para. 10.

argumenton se Mbrojtja nuk është e autorizuar të ngrejë pretendime se janë shkelur të drejtat e të tjerëve, e sa u takon pretendimeve për diskriminim në praktikat e punësimit lidhur me vetë të akuzuarin, parashtrime të tilla janë hamendësuese dhe pa lidhje me çështjen.³⁷ Gjithashtu, sipas ZPS-së për aq sa argumentet e përmendura më lart cekin drejtpërdrejtë statusin e DHS-së sipas nenit 6(1) të KEDNJ-së, ato janë po aq të pathemelta pasi korniza ligjore e zbatueshme nxjerr në pah një supozim të fortë për paanësi dhe pavarësi nga ana e gjykatësve dhe, në qoftë se Mbrojtja pretendon se gjykatësit ndërkombëtarë nuk janë të pavarur dhe të paanshëm, atëherë ky parashtrim është i pabazë.³⁸ Së fundi, lidhur me përparësinë, ZPS-ja parashtron se korniza ligjore e DHS-së kërkon zbatimin e Kushtetutës, Ligjit dhe të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, dhe parësia e DHS-së kundrejt gjykatave të tjera në Kosovë nuk bën ndesh me këtë kornizë dhe është në pajtim me statusin e DHS-së si gjykatë e specializuar.³⁹

3. Kundërpërgjigjja

18. Sipas Mbrojtjes, ligjshmëria e themelimit të DHS-së është një parakusht i nevojshëm për ushtrimin e juridiksionit të DHS-së dhe si e tillë është objekt i shqyrtimit sipas rregullës 97(1)(a) të Rregullores.⁴⁰ Më tej Mbrojtja shton se burimet ligjore ku u mbështet Gjykatësi i Procedurës Paraprake për të konstatuar në çështjen KSC-BC-2020-06, se kundërshtimet e ngritura lidhur me ligjshmërinë e DHS-së nuk përbëjnë kundërshtime juridiksionale, janë të papërshtatshme sepse dy precedentë nuk kishin lidhje me themelimin e gjykatës ndërsa dy precedentët e tjerë ishin miratuar në përputhje me dispozita që dallonin në mënyrë thelbësore nga rregulla 97(1)(a) e Rregullores.⁴¹

³⁷ Përgjigjja, para. 12.

³⁸ Përgjigjja, para. 11, 13-14.

³⁹ Përgjigjja, para. 15.

⁴⁰ Kundërpërgjigjja, para. 3, 8.

⁴¹ Kundërpërgjigjja, para. 4-7.

19. Mbrojtja parashtron se vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, më 15 prill 2015 kishte lidhje me Amendamentin nr. 24 të Kushtetutës dhe jo Ligjin.⁴² Sipas Mbrojtjes, korniza për krijimin dhe funksionimin e DHS-së në pajtim me Ligjin demonstroi se DHS-ja është vendosur jashtë strukturës së sistemit ekzistues të gjykatave dhe funksionon sipas rregullave dhe procedurave të veta pa iu referuar mjaftueshmërisht rendit juridik të Kosovës.⁴³ Më konkretisht Mbrojtja pretendon se: (i) DHS-ja nuk ka lidhje zyrtare institucionale me sistemin e gjyqësorit dhe të prokurorisë së Kosovës; (ii) procedurat e DHS-së nuk zbatojnë Kodin e Procedurës Penale të Kosovës dhe ofrojnë garanci procedurale më të dobëta; (iii) funksionimi i Ligjit si *lex specialis* sjell mungesë qartësie të papranueshme sa u takon dispozitave ligjore përkatëse dhe nuk plotëson kriteret e disponueshmërisë dhe parashikueshmërisë; (iv) parësia e mëtuar e DHS-së devijon nga Kushtetuta dhe parimi madhor i ligjshmërisë; (v) DHS-ja është themeluar që të trajtojë një numër të kufizuar çështjesh; (vi) të gjitha gjykatësit janë ndërkombëtarë dhe janë emëruar sipas praktikave që devijojnë nga praktikat e parapara nga Kushtetuta dhe korniza ligjore shtetërore; dhe (vii) shqiptarët e Kosovës janë tërësisht të përjashtuar nga përfshirja si gjykatës apo punonjës të DHS-së.⁴⁴

20. Mbrojtja parashtron se, në kundërshtim me argumentet e përcepta të ZPS-së, argumenti i saj lidhur me përjashtimin e shqiptarëve të Kosovës nuk ka të bëjë me të drejtat për punësim as të të akuzuarit e as të të tjerëve, as nuk ngre pretendime për mungesë paanshmërie nga ana e gjykatësve ndërkombëtarë.⁴⁵ Mbrojtja pretendon se kjo praktikë përbën diskriminim racor që i heq DHS-së legjitimitetin dhe dëmton besimin lidhur me paanshmërinë objektive të gjykatësve dhe punonjësve të saj.⁴⁶

⁴² Kundërpërgjigjja, para. 9.

⁴³ Kundërpërgjigjja, para. 12.

⁴⁴ Kundërpërgjigjja, para. 13.

⁴⁵ Kundërpërgjigjja, para. 15.

⁴⁶ Kundërpërgjigjja, para. 15.

Gjithashtu, Mbrojtja shton se shqetësimet e përgjithësuara lidhur me situatën e sigurisë në Kosovë nuk mund të justifikojnë këtë ndalim të përgjithshëm.⁴⁷

21. Më tej Mbrojtja argumenton se, në kundërshtim me parashtrimet e ZPS-së, thjesht fakti që DHS-ja është themeluar dhe funksionon nëpërmjet një ndryshimi kushtetues dhe Ligjit, në vetvete nuk mjafton për të dalë në përfundimin se është themeluar me ligj.⁴⁸ Sipas saj, përmendja e termit “ligj” në fjalinë më sipër, përfshin çdo dispozitë të legjislacionit shtetëror i cili nëse shkelet, do ta bënte shqyrtimin e një çështjeje gjyqësore të parregullt.⁴⁹

B. E DREJTA ZAKONORE NDËRKOMBËTARE

1. Mocioni i Mbrojtjes

22. Sipas Mbrojtjes, në rendin juridik të Kosovës, e drejta ndërkombëtare, përfshirë normat lidhur me çështjet penale, nuk kanë efekt të drejtpërdrejtë dhe nuk mund të zbatohen drejtpërdrejt nga gjykatat e Kosovës, përveç nëse e përmbushin standardin e dualizmit.⁵⁰ Mbrojtja parashtron se as Kushtetuta e Kosovës, as Kushtetuta e RSJF-së nuk lejojnë gjykatat e Kosovës, përfshi DHS-në, të zbatojnë ndalimet penale që burojnë nga e drejta zakonore ndërkombëtare pa përfshirjen e tyre në legjislacionin vendor në formën e dispozitave ligjore vendore.⁵¹

23. Sipas saj, neni 3(2)(d) i Ligjit, që duket se mbështetet në nenin 19(2) të Kushtetutës, gabimisht e barazon përfshirjen e së drejtës ndërkombëtare në të drejtën vendore me zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të saj.⁵² Më tej ajo argumenton se, sido që të jetë, kjo dispozitë duhet të interpretohet në përputhje me parimin e ligjshmërisë

⁴⁷ Kundërpërgjigjja, para. 15.

⁴⁸ Kundërpërgjigjja, para. 16.

⁴⁹ Kundërpërgjigjja, para. 16.

⁵⁰ Mocioni i Mbrojtjes, para. 16.

⁵¹ Mocioni i Mbrojtjes, para. 16.

⁵² Mocioni i Mbrojtjes, para. 17.

që garantohet prej nenit 7 të KEDNJ-së dhe nenit 33 të Kushtetutës së Kosovës, në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës Supreme të Kosovës.⁵³

24. Mbrojtja pretendon se Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet të vlerësojë nëse një normë konkrete zakonore përmbush standardin e dualizmit - e një vlerësim i tillë nuk është bërë në Vendimin e Konfirmimit - për të përcaktuar nëse DHS-ja ka juridiksion mbi NKP-në dhe ndalimin arbitrar.⁵⁴

2. Përgjigjja

25. Sipas ZPS-së, pretendimi i Mbrojtjes se DHS-ja nuk mund të ushtrojë juridiksion mbi krimet në kontekstin e të drejtës zakonore ndërkombëtare, në mënyrë themelore keqinterpreton kornizën ligjore të DHS-së dhe shpërfill faktin se legjislatura e Kosovës përzgjedhi dispozitat ligjore përkatëse për themelimin e gjykatës së specializuar sipas kuptimit të nenit 103(7) të Kushtetutës.⁵⁵ Në vlerësimin e saj çështjet ku është bazuar Mbrojtja për të argumentuar se korniza ligjore e RSFJ-së nuk lejonte zbatimin e të drejtës zakonore ndërkombëtare brenda vendit për vërtetimin e veprave penale, janë të papërshtatshme pasi hartuesit përcaktuan se cilat krime brenda së drejtës zakonore ndërkombëtare mund të dënoheshin sipas Ligjit dhe në këtë mënyrë hartuan një ligj shtetëror që lejonte zbatimin e drejtpërdrejtë të së drejtës zakonore ndërkombëtare.⁵⁶ ZPS-ja shton se, për konfirmimin e kushtetueshmërisë së nenit 162 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese e Kosovës mori parasysh, ndër të tjera, se fushëveprimi i juridiksionit të DHS-së duhet të jetë në pajtim me të drejtat e parashikuara në Kapitujt II dhe III të Kushtetutës, përfshirë nenin 33(1) të Kushtetutës që është në përputhje me nenin 7 të KEDNJ-së.⁵⁷ Gjithashtu, ZPS-ja pretendon se lidhur me nenin 33(1) të Kushtetutës, gjykatat në Kosovë kanë shqiptuar dënime për krime lufte

⁵³ Mocioni i Mbrojtjes, para. 17.

⁵⁴ Mocioni i Mbrojtjes, para. 18-19.

⁵⁵ Përgjigjja, para. 16, 19-21.

⁵⁶ Përgjigjja, para. 19, 22.

⁵⁷ Përgjigjja, para. 17, 21.

kur këto krime njiheshin në të drejtën zakonore ndërkombëtare në kohën e kryerjes së tyre dhe se në mënyrë të ngjashme GJEDNJ-ja ka konfirmuar se dënimet për krime sipas së drejtës zakonore ndërkombëtare, edhe ende jo të penalizuar në legjislacionin shtetëror, në vetvete nuk cenojnë parimin e ligjshmërisë.⁵⁸ Së fundi, ZPS-ja argumenton se përmendja e nenit 7(2) të KEDNJ-së në nenin 12 të Ligjit nuk shërben si bazë për zbatueshmërinë e të drejtës zakonore ndërkombëtare sepse neni 7 i KEDNJ-së në tërësi duhet të zbatohet së bashku me nenin 33(1) të Kushtetutës.⁵⁹

26. Për më tepër, ZPS-ja parashtron se e drejta zakonore ndërkombëtare e zbatueshme për krimet që paraqiten në akuza përmbush kriteret e disponueshmërisë dhe parashikueshmërisë ndaj të akuzuarit, me argumentet se: (i) instrumente të ndryshme ndërkombëtare të miratuara pas Luftës së Dytë Botërore bënë të qartë se krimet e luftës ishin vepra penale sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare; (ii) TPNJ-ja ushtroi juridiksionin ndaj krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit në Kosovë gjatë periudhës së akuzave; (iii) veprimet e ndaluara në Kodin Penal të RSFJ-së pasqyrojnë veprimet bazë për të cilat ngrihen akuzat sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare; (iv) RSFJ-ja kishte ratifikuar traktate në lidhje me krimet për të cilat ngrihen akuzat; dhe (v) të gjitha krimet e përfshira në akuza përbëjnë shkelje flagrante të të drejtave të njeriut.⁶⁰

3. Kundërpërgjigjja

27. Mbrojtja kundërpërgjigjet se Ligji i miratuar në vitin 2015, nuk mund të përbëjë bazë ligjore për ndjekjen penale të krimeve që pretendohet se janë kryer në vitin 1999.⁶¹ Sipas Mbrojtjes, edhe nëse merren parasysh argumentet më të mira të ZPS-së, as ndalimi arbitrar në një konflikt të armatosur jondërkombëtar, as përgjegjësia për NKP

⁵⁸ Përgjigjja, para. 18.

⁵⁹ Përgjigjja, para. 23.

⁶⁰ Përgjigjja, para. 24-29.

⁶¹ Kundërpërgjigjja, para. 19, 26.

nuk ishin pjesë e normave juridikisht detyruese, apo nuk ishin pjesë e të drejtës zakonore ndërkombëtare në kohën me të cilën lidhet Aktakuza e Konfirmuar.⁶²

28. Më tej argumentohet se neni 33 i Kushtetutës nuk mbështet parashtrimet e ZPS-së pasi kjo dispozitë duhet interpretuar në pajtim me nenin 7 të KEDNJ-së, e cili nuk lejon penalizimin prapaveprues të sjelljes, dhe sidoqoftë nuk zbatohet në kohën që mbulon Aktakuza e Konfirmuar.⁶³ Në mënyrë të ngjashme, Mbrojtja pretendon se duke qenë se neni 12 i Ligjit mëton të lejojë ndjekjen penale të krimeve të parashikuara në të drejtën zakonore ndërkombëtare të cilat nuk kanë qenë pjesë e kornizës ligjore në fuqi të Kosovës në kohën kur pretendohet se janë kryer veprat penale, atëherë ai nen është në shkelje të nenit 7 të KEDNJ-së.⁶⁴ Për më tepër, sipas Mbrojtjes, mbështetja e ZPS-së në dy çështje të GJEDNJ-së është e papërshtatshme pasi njëra prej tyre lidhet me vlefshmërinë e ndjekjes penale pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore lidhur me krimet që ishin kryer gjatë asaj lufte, e cila nuk mund të zbatohet për ngjarjet e vitit 1999, dhe çështja tjetër ka të bëjë me sjellje të qartë të kundërligjshme që dallon në mënyrë themelore nga konceptet e diskutueshme lidhur me përgjegjësinë penale për NKP dhe krimin e luftës të ndalimit arbitrar në konflikt të armatosur jondërkombëtar.⁶⁵

29. Gjithashtu, sipas Mbrojtjes sugjerimi se nuk bëhet fjalë për prapaveprueshmëri kur ligjvënësi thjesht transponon në legjislacionin vendor krime që ndërkohë kanë qenë detyruese sipas së drejtës ndërkombëtare, shpërfill spektrin e gjerë të mbrojtjes që ofron neni 7 i KEDNJ-së që përfshin kriterin e disponueshmërisë dhe parashikueshmërisë dhe, në përgjithësi, cilësinë e ligjit në fjalë e cila duhet vlerësuar kundrejt kontekstit të caktuar.⁶⁶

⁶² Kundërpërgjigjja, para. 27.

⁶³ Kundërpërgjigjja, para. 19, 27.

⁶⁴ Kundërpërgjigjja, para. 27.

⁶⁵ Kundërpërgjigjja, para. 21-22.

⁶⁶ Kundërpërgjigjja, para. 28.

30. Për më tepër, Mbrojtja pretendon se duke sugjeruar se aktgjykimet përkatëse nga Gjykata Supreme e Kosovës apo Gjykata e Apelit të Kosovës, përfshirë aktgjykimet në çështjet lidhur me bashkëkryesit e pretenduar të z. Shala, nuk kanë lidhje me këtë çështje, ZPS-ja nuk arrin të parashtojë në mënyrë të saktë se për çfarë është kjo jurisprudencë.⁶⁷ Sipas Mbrojtjes, Gjykata Supreme e Kosovës ka zbatuar siç duhet parimin *lex mitior*.⁶⁸

31. Më tej, Mbrojtja është e mendimit se thjesht fakti se disa instrumente të ndryshme ndërkombëtare parashohin se krimet e luftës në përgjithësi përbëjnë vepra penale në të drejtën zakonore ndërkombëtare, nuk do të thotë se i akuzuari mund të kishte parashikuar zbatimin e pretendimeve të ngritura nga ZPS-ja që përbëjnë dhe bazën e këtij procesi dhe konkretisht lidhur me veprën penale të ndalimit arbitrar në konflikt të armatosur jondërkombëtar dhe përgjegjësinë penale për NKP.⁶⁹ Mbrojtja shton se sugjerimi i përgjithshëm se Kodi Penal i RSFJ-së parashihte krime lufte nuk mbështet pretendimet e ZPS-së për të demonstruar se ky kod përfshinte krimin e luftës së ndalimit arbitrar në konflikt të armatosur jondërkombëtar në vitin 1999.⁷⁰ Së fundi, Mbrojtja argumenton se është e qartë se një vlerësim i përciptë mbi sjelljen e z. Shala lidhur me pretendimet konkrete për ndalim arbitrar në konflikt të armatosur jondërkombëtar dhe pjesëmarrje në NKP të cilat nuk kanë asnjë lidhje në vetvete me sjellje të dhunshme, në mungesë të këshillave juridike dhe duke marrë parasysh kornizën e ndërlikuar ligjore të ish-Jugosllavisë dhe kontekstin e luftës në Kosovë, nuk tregon sjellje të gabuar të z. Shala siç pretendohet.⁷¹

⁶⁷ Kundërpërgjigjja, para. 29.

⁶⁸ Kundërpërgjigjja, para.24, 29.

⁶⁹ Kundërpërgjigjja, para. 32.

⁷⁰ Kundërpërgjigjja, para. 33.

⁷¹ Kundërpërgjigjja, para. 34.

32. Më tej, Mbrojtja kërkon nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake ta përcjellë çështjen për gjykim në Dhomën e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës sipas nenit 49(4) të Ligjit, për shkak të rëndësisë themelore të kësaj pike.⁷²

C. NDËRMARRJE KRIMINALE E PËRBASHKËT

1. Mocioni i Mbrojtjes

33. Mbrojtja parashtron se DHS-ja nuk ka juridiksion për të zbatuar NKP-në si formë përgjegjësie penale.⁷³ Mbrojtja kundërshton veçanërisht përdorimin e NKP III pasi vlerëson se rezulton në kundërshti të qartë me parimin e fajësisë.⁷⁴

34. Së pari, sipas Mbrojtjes, NKP-ja nuk ishte pjesë e legjislacionit të Kosovës apo e legjislacionit të ish-Republikës Federale të Jugosllavisë ("RFJ") në kohën e veprave penale të përfshira në akuza.⁷⁵ Më tej shtjellohet se nenet 22, 25(1) dhe 26 në Kodin Penal të RSFJ-së përcaktonin nocionin klasik të bashkëkryerjes dhe nuk mund të barazohen me NKP-në.⁷⁶ Gjithashtu, Mbrojtja kundërshton jurisprudencën e Gjykatës së Apelit të Kosovës në lidhje me NKP-në.⁷⁷

35. Së dyti, Mbrojtja pretendon se në Ligj nuk mund të gjendet bazë ligjore për NKP-në.⁷⁸ Ajo argumenton se neni 16(1)(a) i Ligjit nuk përfshin NKP-në si formë të përgjegjësisë penale, e cila duhet konsideruar si zgjedhje e qëllimshme duke pasur parasysh se Ligji u miratua 15 vjet pas aktgjykimit të Dhomës së Apelit të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë ("TPNJ") që konstatoi se NKP-ja është pjesë e të drejtës zakonore ndërkombëtare në çështjen *Prokurori kundër Dushko Tadiqit* ("Tadiq"), 13 vjet pas hyrjes në fuqi të Statutit të Romës në të cilin shprehimisht hidhet

⁷² Kundërpërgjigjja, para. 23, 30, 49(ii).

⁷³ Mocioni i Mbrojtjes, para. 3, 21.

⁷⁴ Mocioni i Mbrojtjes, para. 4, 24.

⁷⁵ Mocioni i Mbrojtjes, para. 21, 25.

⁷⁶ Mocioni i Mbrojtjes, para. 26-27.

⁷⁷ Mocioni i Mbrojtjes, para. 28.

⁷⁸ Mocioni i Mbrojtjes, para. 21, 29.

poshtë NKP-ja dhe 5 vjet pas hedhjes poshtë të NKP III nga Dhomat e Jashtëzakonshme në Gjykatat e Kamboxhias (DHJGJK).⁷⁹ Gjithashtu, Mbrojtja argumenton se interpretimi i fjalës “kryer” nenin 16(1)(a) të Ligjit për të përfshirë NKP-në dhe në veçanti NKP III, do të ishte në dëm të akuzuarit në shkelje të nenit 7(1) të KEDNJ-së dhe nenit 33 të Kushtetutës.⁸⁰

36. Së treti, Mbrojtja pretendon se edhe sikur Gjykatësi i Procedurës Paraprake të arrinte në përfundimin se e drejta zakonore ndërkombëtare ka efekt të drejtpërdrejtë në DHS, NKP-ja në përgjithësi dhe NKP III në veçanti nuk ishin përcaktuar në të drejtën zakonore në vitin 1999.⁸¹ Sipas Mbrojtjes, Dhoma e Apelit të TPNJ-së në çështjen *Tadiq* ka gabuar kur konstatoi se NKP-ja është pjesë e të drejtës zakonore ndërkombëtare, pasi nuk kishte prova të mjaftueshme si në *opinio juris* dhe në praktikat shtetërore, në mbështetje të atij konstatimi.⁸² Mbrojtja shton se, edhe nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se NKP-ja në përgjithësi është pjesë e të drejtës zakonore ndërkombëtare, ky konstatim nuk mund të përfshijë edhe NKP III.⁸³ Në këtë aspekt, Mbrojtja mbështetet në jurisprudencën e DHJGJK-së që konstatoi se në kohën e kryerjes së krimeve të pretenduara në juridiksionin e DHJGJK-së, nuk kishte prova të mjaftueshme përputhëse të praktikës shtetërore apo *opinio juris* për të dalë në përfundimin se NKP III ishte pjesë e të drejtës zakonore ndërkombëtare.⁸⁴ Mbrojtja kujton se edhe Tribunali Special i Libanit (“TSL”) dhe Gjykata Speciale për Sierra Leonen (“GJSSL”) kanë nxjerrë përfundimin se NKP III si formë e përgjegjësisë penale nuk përfshin krime me synim konkret.⁸⁵ Mbrojtja shton se nuk ekziston asnjë traktat i së drejtës penale ndërkombëtare që të përkufizojë shprehimisht NKP III si formë të përgjegjësisë penale dhe se Statuti i Romës është tregues i fuqishëm se

⁷⁹ Mocioni i Mbrojtjes, para. 30-31.

⁸⁰ Mocioni i Mbrojtjes, para. 32.

⁸¹ Mocioni i Mbrojtjes, para. 4, 21, 33, 43.

⁸² Mocioni i Mbrojtjes, para. 35.

⁸³ Mocioni i Mbrojtjes, para. 36.

⁸⁴ Mocioni i Mbrojtjes, para. 36-37.

⁸⁵ Mocioni i Mbrojtjes, para. 38.

shumica dërrmuese e shteteve nuk e pranuan NKP-në si formë të përgjegjësive penale.⁸⁶ Veç kësaj, Gjykata Supreme e Britanisë së Madhe prapësoi jurisprudencën e vet në lidhje me përgjegjësinë në bazë të ndërmarrjes së përbashkët mbi të cilën ishte mbështetur Dhoma e Apelit e TPNJ-së në çështjen *Tadiq*, dhe konstatoi se në të drejtën anglosaksone në Angli nuk ishte njohur kurrë doktrina e qëllimit të përbashkët të “zgjeruar”.⁸⁷ Së fundi, Mbrojtja u referohet edhe disa botimeve akademike që shkruajnë rreth statusit të diskutueshëm të NKP III.⁸⁸

37. Së katërti, Mbrojtja pretendon se mbështetur në konstatimet e KEDNJ-së, zbatimi i NKP-së nuk ishte mjaftueshëm i parashikueshëm dhe disponueshëm për z. Shala pasi aktgjykimi i apelit në çështjen *Tadiq* u shqiptua më 15 korrik 1999, një muaj pasi kishte përfunduar NKP-ja e pretenduar në të cilën kishte marrë pjesë z. Shala, dhe e drejta penale e Kosovës nuk e përfshinte përgjegjësinë penale sipas asnjë forme të NKP-së.⁸⁹ Më tej parashtron se kjo vlen edhe më shumë për faktin se z. Shala akuzohet për vrasje të paligjshme në bazë të NKP III.⁹⁰

38. Gjithashtu, Mbrojtja është e mendimit se të mbështetesh në NKP si formë të përgjegjësive penale jo vetëm që është e paligjshme por edhe e papërshtatshme duke mbajtur parasysh rrethanat e çështjes së z. Shala dhe në veçanti për faktin se akuzohet për kryerje të drejtpërdrejtë të krimeve të pretenduara në Aktakuzën e Konfirmuar dhe pozitën e tij të parëndësishme në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.⁹¹

⁸⁶ Mocioni i Mbrojtjes, para. 39.

⁸⁷ Mocioni i Mbrojtjes, para. 40.

⁸⁸ Mocioni i Mbrojtjes, para. 24, 39, 42.

⁸⁹ Mocioni i Mbrojtjes, para. 21, 44-45.

⁹⁰ Mocioni i Mbrojtjes, para. 45.

⁹¹ Mocioni i Mbrojtjes, para. 23.

2. Përgjigjja

39. Sipas ZPS-së, përgjegjësia penale në bazë të NKP-së është një nga format e kryerjes së veprës penale sipas nenit 16(1)(a) të Ligjit.⁹² Më tej argumentohet se kjo dispozitë është praktikisht e njëjtë me dispozitat që përcaktojnë format e përgjegjesisë penale në TPNJ, Tribunalin Penal Ndërkombëtar të Ruandës (“TPNR”), Mekanizmin Përmbyllës Ndërkombëtar të Tribunalëve Penalë (“MPNTP”), GJSSL-së dhe DHJGJK.⁹³ ZPS-ja parashtron më tej se në kohën e miratimit të Ligjit në vitin 2015, secila prej gjykatave të lartpërmendura kishte konstatuar në mënyrë përputhëse dhe përsëritëse se “kryerja” e përfshinte NKP-në dhe, zgjedhja prej hartuesve të Ligjit e të njëjtit formulim, nuk lë dyshim se ata kishin si synim zbatimin e NKP-së.⁹⁴ ZPS-ja shton më tej se pesha e krimeve në juridiksionin e DHS-së sipas neneve 13 dhe 14 të Ligjit dhe hedhja poshtë shprehimisht e pengesave të supozuara për ndjekje penale në nenet 16(2), 16(3), dhe 16(4) të Ligjit, tregojnë se Ligji duhet të veprojë ndaj të gjithë kryesve.⁹⁵ Gjithashtu, ZPS-ja parashtron se është i pasaktë pretendimi i Mbrojtjes se përcaktimi i NKP-së si formë e kryerjes së përgjegjesisë penale është interpretim krijues ose “i zgjeruar” i Ligjit duke parë se përgjegjësia penale për kryerje duhet interpretuar që të përfshijë edhe NKP-në në përputhje me praktikën përputhëse dhe të drejtën zakonore ndërkombëtare dhe më pas zbatohet në pajtim me parimet në fuqi për të drejtat e njeriut dhe me Kushtetutën.⁹⁶ Gjithashtu, ZPS është e mendimit se argumentet e ngritura nga Mbrojtja se NKP-ja nuk ishte pjesë e legjislacionit të Kosovës apo RFJ-së shpërfillin bazën ligjore në fuqi lidhur me të drejtën zakonore ndërkombëtare dhe faktin se përgjegjësia penale për NKP-në është zbatuar në gjykatat

⁹² Përgjigjja, para. 48.

⁹³ Përgjigjja, para. 49.

⁹⁴ Përgjigjja, para. 50.

⁹⁵ Përgjigjja, para. 51-52.

⁹⁶ Përgjigjja, para. 53.

e Kosovës kur kanë gjykuar kryerjen e krimeve të luftës në të njëjtën periudhë me krimet që paraqiten në Aktakuzën e Konfirmuar.⁹⁷

40. ZPS-ja parashtron më tej se argumentet e Mbrojtjes kundër statusit të NKP-së në të gjitha format e saj në të drejtën zakonore ndërkombëtare, janë tërësisht të pabaza.⁹⁸ Sipas ZPS-së formulimi në Kartën e Tribunalit Ushtarak Ndërkombëtar (“Karta e TUN-së”) dhe Ligji nr. 10 i Këshillit të Kontrollit (“CCL10”) parashikojnë përgjegjësinë penale për krime që janë pjesë e planit të përbashkët (NKP I), krime të tjera të kryera në zbatim të planit ose lidhur me planin (NKP III), dhe shprehimisht përfshin kryesit që mbajnë përgjegjësi mbi bazën e kontributeve të tyre në kryerjen e krimeve, sipas cilësdo forme kontributi.⁹⁹ ZPS-ja shton se në kundërshtim me pretendimin e pabazuar të Mbrojtjes, aktgjykimi i Dhomës së Apelit të TPNJ-së në çështjen *Tadiq*, dhe shumë panele të tjera në gjykata të ngjashme, kanë konstatuar se çështjet pas Luftës së Dytë Botërore tregojnë se personat e akuzuar u gjykuan mbi bazën e veprimeve të ndërmarra si pjesë e një projekti, qëllimi apo plani të përbashkët me të tjerë.¹⁰⁰ Në vlerësimin e ZPS-së, parimet juridike të zbatuara dhe jurisprudenca nga gjykimet pas Luftës së Dytë Botërore janë pranuar gjerësisht si pjesë përbërëse e të drejtës zakonore ndërkombëtare.¹⁰¹ Gjithashtu, ZPS-ja parashtron se të gjitha gjykatat e tjera të ngjashme kanë dalë në përfundimin se NKP-ja është pjesë e së drejtës zakonore ndërkombëtare, siç gjykoi edhe Gjykatësi i Procedurës Paraprake në çështjen gjyqësore KSC-BC-2020-06.¹⁰² ZPS-ja shtjellon më tej se orvatjet e Mbrojtjes për portretizimin e NKP III si një maskim për përdorimin e “fajësisë për shkak të anëtarësisë” ose “përgjegjësisë së ashpër penale” nuk qëndrojnë, sepse nuk pranojnë se duhet pjesëmarrje e domosdoshme e të akuzuarit në të dhe përgjegjësia penale për NKP III ekziston vetëm kur kryesi, i cili ka pasur synim kriminal, mund ta

⁹⁷ Përgjigjja, para. 54.

⁹⁸ Përgjigjja, para. 55.

⁹⁹ Përgjigjja, para. 56.

¹⁰⁰ Përgjigjja, para. 57.

¹⁰¹ Përgjigjja, para. 58.

¹⁰² Përgjigjja, para. 59-60.

parashikonte dhe e parashikoi mundësinë e kryerjes së një krimi tjetër dhe e mori përsipër atë rrezik me vullnet të lirë.¹⁰³ ZPS-ja argumenton më tej se: (i) nuk ekziston asnjë kriter që përcakton se që një burim ligjor të konsiderohet i vlefshëm, ai duhet të kodifikohet në ndonjë statut apo traktat; (ii) korniza ligjore normative e Gjykatës Penale Ndërkombëtare (“GJPN”) është në themel ndryshe nga DHS-ja; (iii) as literatura e akademikëve dhe as studimet lidhur me praktikën shtetërore nuk mund të përmbysin jurisprudencën e krijuar; (iv) argumenti lidhur me krimet me synim konkret është i pavlefshëm pasi nuk është ngritur asnjë akuzë për krim me synim konkret sipas NKP III; dhe (v) aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Britanisë së Madhe nuk ndikon në statusin e NKP-së si pjesë e të drejtës zakonore ndërkombëtare, konstatuar më herët nga MPNTP-ja dhe ka lidhje me përgjegjësinë penale të bashkëkryerjes ose ndihmës në Angli dhe Uells.¹⁰⁴

41. Së fundi, ZPS-ja prashtron se përgjegjësia penale për NKP-në ishte mjaftueshëm e parashikueshme dhe e disponueshme në kohën përkatëse për të përligjur zbatimin e saj lidhur me të akuzuarin.¹⁰⁵ Sipas ZPS-së, kërkesa për përkufizimin e njëtrajtshëm dhe të saktë të të gjitha elementeve për të konstatuar se përbënin krime apo forma të përgjegjësive penale shpërfill faktin se e drejta penale ndërkombëtare ka ardhur në zhvillim e sipër dhe se e drejta zakonore ndërkombëtare është elastike e jo e ngurtë.¹⁰⁶ ZPS-ja shton se TPNJ-ja dhe DHJGJK-ja kanë konstatuar se në rastin e tribunalëve ndërkombëtarë, disponueshmëria nuk përjashton mbështetjen në një të drejtë që bazohet në zakone.¹⁰⁷ Ajo parashtron se bazuar në kuadrin e gjerë ligjor që lindi pas Luftës së Dytë Botërore, dispozitave të ngjashme në Kodin Penal të RSJF-së dhe

¹⁰³ Përgjigjja, para. 61.

¹⁰⁴ Përgjigjja, para. 62-64.

¹⁰⁵ Përgjigjja, para. 65.

¹⁰⁶ Përgjigjja, para. 65.

¹⁰⁷ Përgjigjja, para. 66.

hetimeve e ndjekjeve penale nga TPNJ-ja, forma e përgjegjesisë penale sipas NKP-së ishte e parashikueshme për të akuzuarin.¹⁰⁸

3. Kundërpërgjigjja

42. Sipas Mbrojtjes, hamendësimi se hartuesit ishin në dijeni mbi mënyrën si janë interpretuar statutet e tribunalëve të tjera penalë ndërkombëtarë nuk justifikon interpretimin e një dispozite të qartë statutores në një mënyrë palejueshmërisht të zgjeruar.¹⁰⁹

43. Mbi të gjitha, Mbrojtja pretendon se mbështetja e ZPS-së në një precedent të muajit maj 2016 nuk mbështet argumentin e saj se NKP-ja ishte pjesë e të drejtës zakonore ndërkombëtare në vitin 1999.¹¹⁰ Më tej parashtrohet se argumenti i përciptë i ZPS-së që hedh poshtë rëndësinë e Statutit të Romës nuk u përgjigjet si duhet argumenteve të Mbrojtjes lidhur me këtë çështje.¹¹¹

44. Gjithashtu, Mbrojtja sqaron se nuk po sugjeron që literatura akademike apo opinionet jashtë gjyqësorit duhet të rrëzojnë jurisprudencën e krijuar, por se iu referua kësaj literature për të demonstruar qëndrimet e ndryshme lidhur me zbatimin e përgjegjesisë penale për NKP.¹¹²

45. Mbrojtja shtjellon më tej se sugjerimi se Dhoma e Apelit të MPNTP-së ka marrë parasysh aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Britanisë së Madhe është i gabuar pasi në fakt ajo mori parasysh vetëm argumentin se kishte arsye bindëse që Dhoma e Apelit të devijonte nga standardi i synimit kriminal në bazë të NKP III për shkak të prapësimit të standardit të ngjashëm në të drejtën angleze lidhur me bashkëkryerjen.¹¹³ Së fundi, Mbrojtja shprehet se fton Gjykatësin e Procedurës

¹⁰⁸ Përgjigjja, para. 67-68.

¹⁰⁹ Kundërpërgjigjja, para. 41.

¹¹⁰ Kundërpërgjigjja, para. 43.

¹¹¹ Kundërpërgjigjja, para. 44.

¹¹² Kundërpërgjigjja, para. 46.

¹¹³ Kundërpërgjigjja, para. 47.

Paraprake të marrë parasysh gabimet logjike dhe papajtueshmërinë me parimet bazë të drejtësisë që sollën një kthesë themelore sa i takon standardit të synimit kriminal në të drejtën angleze që është i rëndësishëm për vlerësimin e statusit të tri formave të NKP-së në të drejtën zakonore ndërkombëtare.¹¹⁴

D. NDALIMI ARBITRAR

1. Mocioni i Mbrojtjes

46. Sipas Mbrojtjes, DHS-ja nuk ka juridiksion mbi ndalimin arbitrar si krim lufte në një konflikt të armatosur jondërkombëtar.¹¹⁵

47. Së pari, Mbrojtja pretendon se ndalimi arbitrar nuk ka qenë vepër penale në legjislacionin e Kosovës në kohën që lidhet me akuzat.¹¹⁶ Më tej parashtrohet se Gjykata Supreme e Kosovës ka konstatuar se përmendja e “arrestimit dhe ndalimit të paligjshëm” në nenin 142 të Kodit Penal të SRFJ-së nuk mund të interpretohet se përfshin ndalimin arbitrar në konflikt të armatosur jondërkombëtar, pasi nuk përbënte vepër penale sipas traktateve në fuqi.¹¹⁷ Gjithashtu, Mbrojtja shton se në përputhje me parimin e ligjshmërisë, kjo sjellje nuk parashihej në nenin e përbashkët 3 të Konventave të Gjenevës të vitit 1949 (“Neni i Përbashkët 3”).¹¹⁸ Mbrojtja më tej shton se pasi Gjykata Themelore e Mitrovicës kishte dënuar një prej bashkëkryesve të pretenduar të z. Shala në bazë të nenit 142 të Kodit Penal të RSFJ-së, Gjykata e Apelit e ricilësoi akuzën për ndalim të paligjshëm si “shtrëngim” dhe në fund e rrëzoi për shkak të tejkalimit të afatit ligjor për ndjekje penale, dhe konstatoi se kjo dispozitë nuk penalizon veprimet që nuk shkaktonin lëndime të rënda fizike apo dëmtime të rënda të shëndetit të viktimave.¹¹⁹

¹¹⁴ Kundërpërgjigjja, para. 48.

¹¹⁵ Mocioni i Mbrojtjes, para. 3, 4, 47.

¹¹⁶ Mocioni i Mbrojtjes, para. 4, 48-49.

¹¹⁷ Mocioni i Mbrojtjes, para. 49.

¹¹⁸ Mocioni i Mbrojtjes, para. 49.

¹¹⁹ Mocioni i Mbrojtjes, para. 50.

48. Së dyti, Mbrojtja parashtron se neni 14(1)(c) i Ligjit nuk përfshin ndalimin arbitrar si krim lufte në konflikt të armatosur jondërkombëtar.¹²⁰ Ajo argumenton se natyra shteruese e kësaj liste del qartë nga cilësimi i ndryshëm i përdorur në nenin 14(1)(b) të Ligjit, i cili përmend shprehimisht “duke i përfshirë veprat e paraqitura në vijim, por jo vetëm ato”.¹²¹ Sipas saj, konstatimi i Gjykatës të Procedurës Paraprake sipas të cilit juridiksioni i DHSK-së nuk kufizohet vetëm në krimet e renditura shprehimisht në nenin 14(1)(c) të Ligjit del jashtë formulimit të qartë të dispozitës dhe kundër parimit të ligjshmërisë të mishëruar në nenin 33(1) të Kushtetutës së Kosovës dhe nenin 7 të KEDNJ-së.¹²²

49. Së treti, sipas parashtrimeve të Mbrojtjes ndalimi arbitrar nuk është shkelje e rëndë e Nenit të Përbashkët 3.¹²³ Ajo pretendon se nuk ekziston pajtim midis shteteve ose studiuesve më të shquar se çfarë përbën ndalim arbitrar në kontekst të një konflikti të armatosur jondërkombëtar dhe siç pasqyrohet në Studimin e të Drejtës Humanitare Zakonore Ndërkombëtare të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (“DHN-ja Zakonore”, “Studimi i DHN-së Zakonore” dhe “KNKK”), është pranuar gjerësisht se heqja e lirisë është një dukuri e pashmangshme por e ligjshme në konflikte të armatosura.¹²⁴ Mbrojtja argumenton se konstatimi i Gjykatës të Procedurës Paraprake në Vendimin e Konfirmimit se çdo rast i mbajtjes në ndalim pa bazë ligjore apo pa garancitë e nevojshme procedurale në rrethana të një konflikti të armatosur jondërkombëtar ngatërron ndalimin arbitrar me trajtimin çnjerëzor.¹²⁵ Në lidhje me këtë Mbrojtja argumenton se siç pasqyrohet në nenet 3 dhe 5 të KEDNJ-së dhe në jurisprudencën përkatëse të GJEDNJ-së, një personi mund t’i hiqet liria në mënyrë arbitrare dhe gjithsesi të mbahet i ndaluar në kushte njerëzore.¹²⁶

¹²⁰ Mocioni i Mbrojtjes, para. 47, 51.

¹²¹ Mocioni i Mbrojtjes, para. 51.

¹²² Mocioni i Mbrojtjes, para. 51.

¹²³ Mocioni i Mbrojtjes, para. 47, 52.

¹²⁴ Mocioni i Mbrojtjes, para. 53.

¹²⁵ Mocioni i Mbrojtjes, para. 54.

¹²⁶ Mocioni i Mbrojtjes, para. 54.

50. Së katërti, Mbrojtja pretendon se ndalimi arbitrar nuk ka qenë i ndaluar prej të drejtës zakonore ndërkombëtare në vitin 1999.¹²⁷ Sipas argumenteve të saj, Studimi i KNNK-së në të cilin Gjykatësi i Procedurës është mbështetur pothuajse në mënyrë ekskluzive, është shprehje e aspiratës për një parim që nuk mbështetet nga asnjë burim tjetër bindës i të drejtës ndërkombëtare.¹²⁸ Mbrojtja është e mendimit se: (i) hera e parë që KNKK-ja sugjeroi se ndalimi arbitrar ndalohet nga e drejta humanitare ndërkombëtare ishte në vitin 2005; (ii) është e paqartë nëse penalizimi i heqjes arbitrare të lirisë që gjendet në legjislacionin e afërsisht 60 shteteve në të cilat bazohet Studimi i KNKK-së vlen për të dy kategoritë e konfliktit të armatosur; dhe (iii) shumë nga kodet penale të përmendura në Studim u miratuan pas vitit 1999.¹²⁹ Mbrojtja shton më tej se praktika shtetërore e cituar në Studimin e KNKK-së që ka të bëjë me një pakicë relative të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara (“OKB”) nuk mjafton për përmbushjen e standardit “e gjerë dhe praktikisht të njëtrajtshëm” të domosdoshëm për vërtetimin e ekzistencës së një rregulle zakonore.¹³⁰ Për më tepër, sipas Mbrojtjes, u jepet rëndësi e tepruar materialeve me shkrim përkundrejt praktikave operative të shteteve gjatë konflikteve të armatosura.¹³¹

51. Së fundi, Mbrojtja pretendon se, për shkak të pasigurive që shoqërojnë nocionin e arbitraritetit kur është fjala për ndalimin dhe në mungesë të ndonjë rregulle shtetërore ose ndërkombëtare që ndalon heqjen arbitrare të lirisë në konflikt të armatosur jondërkombëtar gjatë periudhës që mbulon Aktakuza, z. Shala nuk mund të kishte parashikuar se do të mund të akuzohej për atë vepër.¹³²

¹²⁷ Mocioni i Mbrojtjes, para. 47, 58-59.

¹²⁸ Mocioni i Mbrojtjes, para. 55.

¹²⁹ Mocioni i Mbrojtjes, para. 56.

¹³⁰ Mocioni i Mbrojtjes, para. 57.

¹³¹ Mocioni i Mbrojtjes, para. 57.

¹³² Mocioni i Mbrojtjes, para. 47, 60.

2. Përgjigjja

52. ZPS-ja argumenton se parashtrimet e Mbrojtjes në lidhje me ndalimin arbitrar përsërisin kundërshtimet që Gjykatësi i Procedurës Paraprake shqyrtoi së fundi në kontekstin e Çështjes KSC-BC-2020-06 dhe nuk ka arsye për rivlerësim të atij konstatimi.¹³³

53. Sipas ZPS-së, ndonëse moslejimi i ndalimit arbitrar nuk renditet shprehimisht në nenin 14 të Ligjit, kjo nuk është e nevojshme sepse garancia themelore kundër ndalimit arbitrar është e papezullueshme dhe respektimi i të drejtave themelore dhe të papezullueshme është një element i domosdoshëm për moslejimin e trajtimit çnjerëzor të mishëruar në Nenin e Përbashkët 3.¹³⁴ ZPS-ja shton se neni 14(1)(c) i Ligjit përdor fjalën “përfshirë” dhe interpretimi i thjeshtë dhe tekstual i kësaj fjale nënkupton një listë joshteruese të veprimeve të ndaluara.¹³⁵ Nga pikëpamja e ZPS-së, fakti se formulimi i përdorur në nenin 14 të Ligjit nuk është i njëjtë në pjesë të ndryshme teksti nuk ndryshon karakterin e fjalës “përfshirë” pasi edhe formulimet e tjera në mënyrë të ngjashme nënkuptojnë karakterin joshterues të veprimeve të renditura.¹³⁶ Për më tepër, ZPS-ja parashtron se nuk ekziston shkelje e ligjshmërisë pasi DHS-ja ka juridiksion mbi një vepër penale vetëm në qofte se ka ekzistuar sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare në kohën përkatëse.¹³⁷

54. ZPS-ja shton më tej se moslejimi i ndalimit arbitrar në konflikt të armatosur jondërkombëtar është pjesë e të drejtës zakonore ndërkombëtare.¹³⁸ Ajo parashtron se Studimi i KNKK-së citon një mori burimesh shtetërore dhe ndërkombëtare që vërtetojnë praktika shtetërore dhe *opinio juris*.¹³⁹ ZPS-ja mendon se mbështetja në praktikën pas periudhës që mbulon Aktakuza e Konfirmuar mund të jetë relevante

¹³³ Përgjigjja, para. 30.

¹³⁴ Përgjigjja, para. 32.

¹³⁵ Përgjigjja, para. 33.

¹³⁶ Përgjigjja, para. 33.

¹³⁷ Përgjigjja, para. 33.

¹³⁸ Përgjigjja, para. 34.

¹³⁹ Përgjigjja, para. 35-37.

për të treguar zhvillimin e vazhdueshëm të një rregulle zakonore.¹⁴⁰ Gjithashtu, sipas ZPS-së standardi për trajtim njerëzor zbatohet njësoj sipas të drejtës humanitare ndërkombëtare dhe është vërtetuar se ndalimi arbitrar përbën sjellje që shkel parimin e trajtimit njerëzor.¹⁴¹ ZPS-ja më tej pretendon se të drejtat për gjykim të drejtë të garantuara në Nenin e Përbashkët 3(1)(d) janë të papajtueshme me lejimin e ndalimit arbitrar në një konflikt të armatosur jondërkombëtar.¹⁴²

55. Gjithashtu, ZPS-ja pretendon se ndalimi arbitrar përbën shkelje të rëndë të Nenit të Përbashkët 3 i cili synon të mbrojë së pari të drejtat themelore të jetës, lirisë dhe sigurisë së personit si dhe të drejta të tjera të njeriut.¹⁴³ ZPS-ja argumenton se parashtrimet e Mbrojtjes mbi ndalimin arbitrar në kushte çnjerëzore ngatërrojnë kuadrin ligjor të zbatueshëm pasi duket se e kufizojnë trajtimin njerëzor brenda kornizës së ngushtë të kushteve të ndalimit.¹⁴⁴

56. Së fundi, sipas ZPS-së, moslejimi i ndalimit arbitrar ishte plotësisht i disponueshëm dhe parashikueshëm për të akuzuarin, bazuar edhe në ekzistencën e bazës ligjore në fuqi për moslejimin e ndalimit arbitrar në vendet e ish-Jugosllavisë si dhe në deklaratat e organizatave ndërkombëtare si OKB-ja.¹⁴⁵

3. Kundërpërgjigjja

57. Mbrojtja mendon se qëndrimi i ZPS-së se neni 14(1)(c) i Ligjit përcakton një listë joshteruese të veprimeve të ndaluara hidhet poshtë nga teksti i qartë i atij paragrafi i cili ndryshon nga teksti në paragrafët (b) dhe (d) të kësaj dispozite.¹⁴⁶ Mbrojtja shton se kjo nuk mund të interpretohet si harresë e paqëllimshme.¹⁴⁷ Në pikëpamjen e

¹⁴⁰ Përgjigjja, para. 37.

¹⁴¹ Përgjigjja, para. 39.

¹⁴² Përgjigjja, para. 40.

¹⁴³ Përgjigjja, para. 41.

¹⁴⁴ Përgjigjja, para. 42.

¹⁴⁵ Përgjigjja, para. 35-36, 43-44.

¹⁴⁶ Kundërpërgjigjja, para. 35.

¹⁴⁷ Kundërpërgjigjja, para. 35.

Mbrojtjes, neni 14(1)(c) i Ligjit nuk mund të interpretohet logjikisht si joshterues duke marrë parasysh përmendjen e qartë dhe përmbajtjen e njëjtë të veprimeve konkrete që renditen në të.¹⁴⁸

58. Gjithashtu, Mbrojtja parashtron se as shembujt e kufizuar në të cilat është mbështetur ZPS-ja dhe as konstatimet e saj se ndalimi arbitrar është i palejueshëm nuk e mbështesin qëndrimin e saj.¹⁴⁹ Së fundi, Mbrojtja argumenton se neni 142 i Kodit Penal të SRFJ-së nuk e përmban veprën konkrete për të cilën akuzohet z. Shala.¹⁵⁰

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSË

A. MOCIONET PARAPRAKE

59. Në pajtim me nenin 39(1) të Ligjit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka kompetencë për ta shqyrtuar aktakuzën, për të marrë vendim në lidhje me çdo mocion paraprak, përfshirë edhe kundërshtimet ndaj aktakuzës dhe juridiksionit, si dhe që të nxjerrë urdhër apo vendim të nevojshëm për të siguruar që çështja të përgatitet siç duhet dhe në mënyrë të shpejtë për gjykim.

60. Sipas rregullës 97(1) të Rregullores, i akuzuari mund të paraqesë mocione paraprake që nuk njohin juridiksion e DHS-së, pretendojnë mangësi në formën e Aktakuzës dhe kërkojnë veçimin e akuzave sipas rregullës 89(2).

B. THEMELIMI I DHOMAVE TË SPECIALIZUARA

61. Në pajtim me nenin 103(7) të Kushtetutës, gjykata të specializuara mund të themelohen me ligj kur kjo të jetë e nevojshme, por në asnjë mënyrë nuk mund të themelohen gjykata të jashtëzakonshme.

¹⁴⁸ Kundërpërgjigjja, para. 36.

¹⁴⁹ Kundërpërgjigjja, para. 38.

¹⁵⁰ Kundërpërgjigjja, para. 39.

62. Sipas nenit 162(1) të Kushtetutës, për të përmbushur detyrimet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me Raportin e Këshillit të Evropës, Republika e Kosovës mund të themelojë DHS-në dhe një ZPS në kuadër të sistemit të drejtësisë së Kosovës. Organizimi, funksionimi dhe juridiksioni i DHS-së dhe ZPS-së rregullohen nga ky nen dhe një ligj i posaçëm.

C. E DREJTA ZAKONORE NDËRKOMBËTARE

63. Sipas nenit 22 të Kushtetutës, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara në marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen nga kjo Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejt në Kosovë dhe në rast mospajtimi kanë përparësi ndaj dispozitave ligjore dhe akteve të tjera të institucioneve publike:

[...]

(2) KEDNJ-në me Protokollet;

(3) Konventa Ndërkombëtare për Të Drejtat Civile dhe Politike dhe Protokollet e saj ("KNDCP");

[...].

64. Sipas nenit 33(1) të Kushtetutës, askush nuk mund të akuzohet ose të dënohet për një vepër e cila në momentin e kryerjes, nuk ka qenë e përcaktuar me ligj si vepër penale, me përjashtim të veprave të cilat, në kohën e kryerjes së tyre, sipas së drejtës ndërkombëtare, përbënin gjenocid, krime lufte ose krime kundër njerëzimit.

65. Sipas nenit 3(2) të Ligjit, DHS-ja gjykon dhe funksionon në përputhje me,

- a. Kushtetutën e Republikës së Kosovës;
- b. Ligjin, si *lex specialis*;
- c. dispozitat e tjera të ligjeve të Kosovës të përfshira shprehimisht në këtë Ligj dhe të zbatuara nga ky Ligj;

- d. të drejtën zakonore ndërkombëtare të cilës i është dhënë përparësi kundrejt ligjeve vendore me nenin 19(2) të Kushtetutës; dhe
- e. të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut që përcakton standardet e drejtësisë penale përfshirë KEDNJ-në dhe KNDCP, të cilave u është dhënë përparësi kundrejt ligjeve vendore me nenin 22 të Kushtetutës.

66. Sipas nenit 12 të Ligjit, DHS-ja zbaton të drejtën zakonore ndërkombëtare dhe të drejtën penale materiale të Kosovës nëse është në përputhje me të drejtën zakonore ndërkombëtare, që kanë qenë të zbatueshme në kohën e kryerjes së krimeve, në pajtim me nenin 7(2) të KEDNJ-së dhe nenin 15(2) të KNDCP-së, të përfshira dhe të mbrojtura nga nenet 19(2), 22(2), 22(3) dhe 33(1) të Kushtetutës.

D. NDËRMARRJA KRIMINALE E PËRBASHKËT

67. Sipas nenit 16(1)(a) të Ligjit, për krimet nga nenet 13-14 të Ligjit, personi i cili ka planifikuar, nxitur, urdhëruar, kryer, ose në ndonjë mënyrë tjetër ka ndihmuar dhe ka dhënë mbështetje për planifikimin, përgatitjen ose kryerjen e këtij krimi, mban përgjegjësi individuale për krimin.

E. NDALIMI ARBITRAR

68. Sipas nenit 14(1)(c) të Ligjit, për qëllimet e këtij ligji, sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare gjatë juridiksionit kohor të DHS-së, me krime të luftës nënkuptohen: [...] në rast të ndonjë konflikti të armatosur që nuk është i karakterit ndërkombëtar, shkeljet e rënda të Nenit të Përbashkët 3, duke i përfshirë veprat në vijim të kryera kundër personave që nuk janë pjesë aktive e luftimeve, përfshirë kundër pjesëtarëve të forcave të armatosura që i kanë dorëzuar armët dhe atyre që janë kanë dalë jashtë luftimit për shkak të sëmundjeve, plagëve, ndalimit apo ndonjë arsyeje tjetër [...].

IV. DISKUTIM

A. ASPEKTET PARAPRAKE

1. Lloji i Mocionit të Mbrojtjes

69. Para së gjithash është e nevojshme të përcaktohet lloji i Mocionit të Mbrojtjes. Neni 39(1) i Ligjit përcakton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake mund të vendosë mbi çdo mocion paraparak, ku përfshihen ndër të tjera edhe kundërshtimet ndaj aktakuzës dhe juridiksionit. Rregulla 97(1) dhe (3) e Rregullores kristalizon më tej kuadrin ligjor që zbatohet për format më të zakonshme të mocioneve paraprake, konkretisht për të bërë dallimin mes mocioneve paraprake ku e drejta e apelit është e vetvetishme (pra mocionet që ngrenë kundërshtime për juridiksionin e DHS-së) dhe atyre për të cilët duhet autorizim para se të miratohet apeli. Rregulla 97(1)(a) e Rregullores nuk i përkufizon kundërshtimet juridiksionale. Megjithatë, nenet 6 deri në 9 të Ligjit përcaktojnë bazën tradicionale të juridiksionit: juridiksioni lëndor, kohor, territorial dhe personal. Kundërshtimet e ngritura në lidhje me themelimin e DHS-së dhe ZPS-së dhe shkeljet e pretenduara ndaj të drejtave kushtetuese të akuzuarit nuk janë pjesë e këtyre katër kategorive tradicionale të juridiksionit. Megjithëse në disa raste është konstatuar se kundërshtimet e ngritura në lidhje me juridiksionin mund të përfshijnë aspekte të zgjeruara lidhur me ligjshmërinë e një institucioni,¹⁵¹ në raste të tjera juridiksioni është përkufizuar në mënyrë shumë më të ngushtë.¹⁵²

¹⁵¹ TPNJ, *Prosecutor v. Tadić*, IT-94-1, Appeals Chamber, [Decision on the Defence Motion for Interlocutory Appeal on Jurisdiction](#) (“Tadić Interlocutory Appeal Decision”), 2 October 1995, para. 6; ICTR, *Prosecutor v. Kanyabashi*, ICTR-96-15-T, Trial Chamber, [Decision on the Defence Motion on Jurisdiction](#), 18 June 1997, para. 6.

¹⁵² Vërehet se koncepti më i ngushtë i juridiksionit në TPNJ dhe TPNR u zbatua pas një ndryshimi të Rregullores që përcaktoi kundërshtimet juridiksionale. ICTR, *Nzirorera v. The Prosecutor*, ICTR-98-44-AR72, Appeals Chamber, [Decision Pursuant to Rule 72\(E\) of the Rules of Procedure and Evidence on Validity of Appeal of Joseph Nzirorera Regarding Chapter VII of the Charter of the United Nations](#), 10 June 2004, paras 9-10; TPNJ, *Prosecutor v. Tolimir*, Appeals Chamber, IT-05-88/2-AR72.2, [Decision on Zdravko Tolimir’s Appeal Against the Decision on Submissions of the Accused Concerning Legality of Arrest](#), 12 March 2009,

70. Sa u takon parashtrimeve të Mbrojtjes në lidhje me burimet ligjore e marra parasysh në mbështetje të konstatimit të mëparshëm,¹⁵³ Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton se ky konstatim, para së gjithash, del nga kuptimi i qartë i termave në rregullën 97(1)(a) të Rregullores, të interpretuara sipas kontekstit të tyre, në veçanti nenet 6 deri 9 të Ligjit, të cilat përcaktojnë bazën tradicionale të këtij juridiksioni. Burimet ligjore të përmendura më lart demonstrojnë se, megjithëse është pranuar se kundërshtimet e ngritura në lidhje me juridiksionin mund të përfshijnë aspekte të zgjeruara lidhur me ligjshmërinë e një institucioni, në raste të tjera juridiksioni mund të përkufizohet në mënyrë shumë më të ngushtë. Pra, këto burime ligjore nuk përcaktojnë, në vetvete, se kundërshtimet e ngritura për juridiksionin përjashtojnë aspekte lidhur me themelimin e DHS-së sipas kornizës ligjore të DHS-së. Në fakt ato mbështesin interpretimin e mësipërm të rregullës 97(1)(a) të Rregullores bazuar në sugjerimin e përgjithshëm se juridiksioni nuk është një koncept i pakufizuar në të drejtën penale ndërkombëtare. Për rrjedhojë, parashtrimet e Mbrojtjes rrëzohen.

71. Gjithashtu, lidhur me kundërshtimin ndaj themelimit të DHS-së dhe/ose pretendimin se janë shkelur të drejtat kushtetuese të të akuzuarit, Mocioni i Mbrojtjes nuk ngre çështje lidhur me juridiksionin pasi këto parashtrime nuk janë pjesë e kuptimit të qartë të neneve 6 deri në 9 të Ligjit dhe si rrjedhojë nuk përbëjnë kundërshtime juridiksionale.¹⁵⁴ Sidoqoftë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do t'i

public, paras 11-12; *Prosecutor v. Karadžić*, IT-95-5/18-T, Trial Chamber, [Decision on the Accused's Motion Challenging the Legal Validity and Legitimacy of the Tribunal](#), 7 December 2009, public, para. 8; STL, *Prosecutor v. Ayyash et al.*, STL-11-01/FT/AC/AR90.1, Appeals Chamber, [Decision on the Defence Appeals Against the Trial Chamber's "Decision on the Defence Challenges to the Jurisdiction and Legality of the Tribunal"](#), 24 October 2012, para. 18. Lidhur me shkeljen e të drejtave jashtë fushëveprimit të kundërshtimeve juridiksionale, shih ICC, *Prosecutor v. Lubanga*, ICC-01/04-01/06-722, Appeals Chamber, [Judgment on the Appeal of Mr. Thomas Lubanga Dyilo against the Decision Defence Challenge to the Jurisdiction of the Court Pursuant to Article 19\(2\)\(a\) of the Statute of 3 October 2006](#), 14 December 2006, public, paras 21-22, 24.

¹⁵³ Kundërpërgjigjja, para. 5-7.

¹⁵⁴ Shih edhe KSC-BC-2020-06, F00450, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime ndaj Ligjshmërisë së DHS-së dhe ZPS-së dhe Shkeljen e Pretenduar të Disa të Drejtave Kushtetuese të Akuzuarve* ("Thaçi dhe të tjerë. Vendim për Ligjshmërinë"), 31 gusht 2021, publik, para. 54.

trajtojë këto parashtrime sipas kompetencës që i jep neni 39(1) i Ligjit.¹⁵⁵ Rrjedhimisht, në pjesët më poshtë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të trajtojë Mocionin e Mbrojtjes, së pari sipas nenit 39(1) të Ligjit për kundërshtimin e ngritur në lidhje me themelimin e DHS-së dhe/ose pretendimin për shkeljen e të drejtave kushtetuese të të akuzuarit dhe, së dyti, sipas rregullës 97(1)(a) të Rregullores për kundërshtimin lidhur me juridiksionin sipas kuptimit të neneve 6-9 të Ligjit.

2. Seanca gojore

72. Kujtojmë se në bazë të kornizës ligjore të DHS-së, seancat gojore janë rreptësisht të domosdoshme në disa raste,¹⁵⁶ ndërsa në raste të tjera mund të mbahen sipas nevojës.¹⁵⁷ Sa u takon aspekteve të ngritura në Mocionin e Mbrojtjes, seanca nuk është detyruese në bazë të Ligjit dhe Rregullores.

73. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se Mbrojtja nuk ka dhënë arsye konkrete për të mbështetur kërkesën për seancë gojore. Veç kësaj, sikurse është përcaktuar më lart, Mbrojtjes i është miratuar shtyrje e afatit për dorëzimin e Mocionit të saj si dhe shtim i numrit të lejuar të fjalëve për Kundërpërgjigjen e saj.¹⁵⁸ Rrjedhimisht, Mbrojtja ka pasur shumë mundësi për të paraqitur parashtrimet e veta. Për më tepër, pasi shqyrtoi parashtrimet e zgjeruara të palëve, Gjykatësi i Procedurës Paraprake është i mendimit se ka informacion të mjaftueshëm për të vendosur lidhur me Mocionin e Mbrojtjes dhe se argumentet me gojë nuk janë as të nevojshme dhe as të përshtatshme për gjykimin e shpejtë të aspekteve në fjalë. Si rrjedhojë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake refuzon kërkesën e Mbrojtjes.

¹⁵⁵ *Shih edhe* Thaçi dhe të tjerë. Vendim për Ligjshmërinë, para. 55.

¹⁵⁶ *Për shembull* neni 41(5) i Ligjit; rregulla 92 e Rregullores (paraqitjet paraprake); rregulla 96 e Rregullores (konferencat për ecurinë e çështjes).

¹⁵⁷ *Për shembull* rregulla 95(2)(d) e Rregullores; *shih gjithashtu* KSC-BC-2020-06, F00178, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Kadri Veselit për Lirim të Përkohshëm*, 22 janar 2021, publik, para. 62; F00150, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kryerjen e Rishikimit të Paraburgimit dhe Ndryshimin e Afatit për Mocionet Paraprake*, 16 dhjetor 2020, publik, para. 18.

¹⁵⁸ *Shih* para. 4 dhe 6 më lart.

B. THEMELIMI DHOMAVE TË SPECIALIZUARA

74. Si fillim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se parashtrimet e Mbrojtjes se korniza që rregullon proceset e DHS-së ofron garanci procedurale më të dobëta se Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, janë ngritur për herë të parë në Kundërpërgjigjen e saj.¹⁵⁹ Në pajtim me rregullën 76 të Rregullores, kundërpërgjigjja ose pjesë të saj merren në shqyrtim vetëm nëse kanë të bëjnë me çështje të reja që dalin nga përgjigjja. Si rrjedhojë, ky parashtrim rrëzohet in limine.

75. Lidhur me argumentin se DHS-ja është themeluar për të trajtuar një numër të kufizuar çështjesh,¹⁶⁰ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se DHS-ja u themelua për të trajtuar krimet që lidhen me Raportin e Këshillës së Evropës, siç parashihet në nenin 162 të Kushtetutës dhe se në pajtim me nenet 6-7 dhe 13-15 të Ligjit ka juridiksion mbi një gamë të gjerë krimesh lufte dhe krimesh kundër njerëzimit të cilat lidhen me Raportin e Këshillit të Evropës, të kryera nga 1 janari 1998 deri më 31 dhjetor 2000. Sikurse është përcaktuar më parë, rrjedh se megjithëse juridiksioni i DHS-së nuk është i pakufizuar, është sidoqoftë mjaftueshmërisht i përgjithshëm dhe abstrakt për të përfshirë një mori krimesh të shumta dhe kategori kryesish të tyre brenda kufijve të tij.¹⁶¹ Si rrjedhojë, argumenti i Mbrojtjes rrëzohet.

76. Në lidhje me pretendimet e Mbrojtjes për personelin ndërkombëtar Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se kjo pikë,¹⁶² është trajtuar më parë nga Gjykata Kushtetutës e Kosovës e cila konstatoi se DHS-ja është themeluar me ligj sipas nenit 6(1) të KEDNJ-së. Në veçanti, Gjykata Kushtetuese e Kosovës shpalli se themelimi i DHS-së është i domosdoshëm në përmbushje të detyrimeve ndërkombëtare të Kosovës që burojnë nga Raporti i Këshillit të Evropës, të cilat u përfshinë në kornizën

¹⁵⁹ Kundërpërgjigjja, para. 13.

¹⁶⁰ Mocioni i Mbrojtjes, para. 2, 7, 8; Kundërpërgjigjja, para. 13.

¹⁶¹ *Shih edhe* Thaçi dhe të tjerë. Vendim për Ligjshmërinë, para. 114.

¹⁶² Mocioni i Mbrojtjes, para. 2, 7, 9-11; Kundërpërgjigjja, para. 13-16.

ligjore të Kosovës me anë të Ligjit nr. 04/L-274.¹⁶³ Ligji në fjalë ratifikon marrëveshjen ndërkombëtare të mundësuar me anë të shkëmbimit të letrave midis Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Kjo marrëveshje ndërkombëtare parasheh, ndër të tjera, se në gjykatën speciale të themeluar për kryerjen e gjykimeve dhe procedurat e apelit që dalin nga hetimet e Task Forcës Hetimore Speciale do të punësohen dhe do të punojnë vetëm punonjës ndërkombëtarë.¹⁶⁴ Veç kësaj, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka konstatuar dhe më parë se DHS-ja është e pavarur dhe e paanshme.¹⁶⁵ Më konkretisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka gjykuar se, duke pasur parasysh kornizën e gjerë ligjore që rregullon funksionimin e DHS-së, që përfshin ndër të tjera Kushtetutën, Ligjin si *lex specialis* dhe të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, nuk mund të thuhet se DHS-ja funksionon jashtë kornizës ligjore të Kosovës.¹⁶⁶ Gjithashtu, sa i takon emërimit të gjykatësve është shpallur se neni 28 e përcakton qartë sistemin përkatës.¹⁶⁷ Më tej është konstatuar se nuk është demonstruar konkretisht si ndikon mosprania e shqiptarëve të Kosovës në sistemin e gjyqësorit në këto vlerësime.¹⁶⁸ Së fundi, në lidhje me pretendimet e Mbrojtjes se punësimi i personelit ndërkombëtar prej DHS-së dëmton legjitimitetin e saj në Kosovë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se Mbrojtja nuk ka paraqitur arsye ligjore.¹⁶⁹ Për rrjedhojë, parashtrimet e Mbrojtjes duhen rrëzuar.

77. Në lidhje me pretendimin e Mbrojtjes së Ligji mëton t'i japë përparësi DHS-së ndaj gjykatave të tjera në Kosovë,¹⁷⁰ është konstatuar më parë se DHS-ja vepron në përputhje me kornizën e gjerë ligjore që rregullon procedurat e saj dhe fakti se ka

¹⁶³ *Shih edhe* Thaçi dhe të tjerë. Vendim për Ligjshmërinë, para. 86-88; Gjykata Kushtetuese, *Vlerësim i amendamentit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe referuar me 9 mars 2015 nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, me Shkresën nr. 05-433/DO-318, K026/15, 15 prill 2015, para. 50-51.*

¹⁶⁴ Ligji nr. 04/L-274, Shtojca.

¹⁶⁵ Thaçi dhe të tjerë. Vendim për Ligjshmërinë, para. 100-110.

¹⁶⁶ *Shih* Thaçi dhe të tjerë. Vendim për Ligjshmërinë, para. 101.

¹⁶⁷ *Shih* Thaçi dhe të tjerë. Vendim për Ligjshmërinë, para. 102; *shih edhe* para. 103-109.

¹⁶⁸ *Shih* Thaçi dhe të tjerë. Vendim për Ligjshmërinë, para. 110.

¹⁶⁹ *Ngjashëm* Thaçi dhe të tjerë. Vendim për Ligjshmërinë, para. 110.

¹⁷⁰ Mocioni i Mbrojtjes, paras 2, 7, 12; Kundërpërgjigjja, para. 13.

përparësi mbi gjykatat e tjera në Kosovë nuk ka ndikim në këtë analizë pasi DHS-ja duhet të funksionojë, ndër të tjera, në përputhje me Kushtetutën, Ligjin si *lex specialis*, dhe të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.¹⁷¹ Rrjedhimisht, pretendimet e Mbrojtjes nuk duhen marrë parasysh. Sa i takon pretendimit të ngjashëm të Mbrojtjes se Ligji devijon nga Kushtetuta dhe ligje të tjera penale materiale pasi nenet 3(2)(d) dhe 12 të Ligjit i japin përparësi të drejtës zakonore,¹⁷² Gjykatësi i Procedurës Paraprake, siç dhe shtjellohet në vijim,¹⁷³ ka konstatuar më parë se: (i) me miratimin e Ligjit si instrumenti kryesor që rregullon procedurat e DHS-së, ligjvënësi thjesht ka transpozuar në legjislacionin e kodifikuar shtetëror vepra penale që ishin pjesë e rendit juridik e të cilat ishin detyruese për personat sipas së drejtës ndërkombëtare; dhe (iii) zbatimi i të drejtës zakonore ndërkombëtare ishte i disponueshëm dhe i parashikueshëm në kohën përkatëse.¹⁷⁴ Pretendimi i Mbrojtjes se Ligji është jokushtetues sepse i jep përparësi të drejtës zakonore ndërkombëtare, rrëzohet për të njëjtat arsye.

78. Së fundi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vlerëson se janë të pabaza pretendimet e Mbrojtjes se, pavarësisht se e drejta zakonore ndërkombëtare përmendet në nenin 14(1)(c) të Ligjit, zbatimi i saj si për elementet e veprave penale për të cilat ngrihen akuzat, po ashtu edhe për format e përgjegjësisë penale, duhet kryer në përputhje me nenin 33 të Kushtetutës.¹⁷⁵ Mbrojtja nuk parashton konkretisht se cilat vepra penale për të cilat ngrihen akuzat dhe forma të përgjegjësisë penale nuk përmbushin parimin e ligjshmërisë dhe si këto vepra penale dhe forma të përgjegjësisë nuk janë në përputhje me standardet e zbatueshme. Rrjedhimisht, ky argument rrëzohet. Sidoqoftë, argumentet konkrete të Mbrojtjes në lidhje me të drejtën zakonore

¹⁷¹ *Shih* Thaçi dhe të tjerë. Vendim për Ligjshmërinë, para. 101.

¹⁷² Mocioni i Mbrojtjes, paras 12-14; Kundërpërgjigjja, para. 13.

¹⁷³ *Shih* para. 82-87 më poshtë.

¹⁷⁴ *Shih* KSC-BC-2020-06, F00412, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim ndaj Mocioneve që ngrenë Kundërshtime për Juridiksionin e Dhomave të Specializuara* ("Thaçi dhe të tjerë. Vendim lidhur me Juridiksionin"), 22 korrik 2021, publik, para. 88-104.

¹⁷⁵ Mocioni i Mbrojtjes, para. 7, 15.

ndërkombëtare, NKP-në dhe ndalimin arbitrar, përfshirë zbatimin e parimit të ligjshmërisë, do të trajtohen në pjesët vijuese.¹⁷⁶

79. Duke pasur parasysh konstatimet pararendëse, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rrezon argumentin në Mocionin e Mbrojtjes se DHS-ja është *de facto* gjykatë e jashtëzakonshme.

C. JURIDIKSIONI I DHOMAVE TË SPECIALIZUARA

1. E Drejta Zakonore Ndërkombëtare

80. Si fillim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se parashtrimet e Mbrojtjes lidhur me zbatueshmërinë e të drejtës zakonore ndërkombëtare, NKP-në dhe ndalimin arbitrar përkojnë në disa raste.¹⁷⁷ Megjithatë, për faktin se Mocioni i Mbrojtjes dhe Kundërpërgjigjja i kushtojnë pjesë të posaçme këtyre aspekteve, pavarësisht se kanë pika të përbashkëta që përkojnë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake kupton që Mbrojtja nga një anë ngre kundërshtim mbi zbatueshmërinë e të drejtës zakonore ndërkombëtare dhe nga ana tjetër mbi juridiksionin e DHS-së ndaj ndalimit arbitrar dhe NKP-së.¹⁷⁸ Për rrjedhojë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake në fillim do të trajtojë aspektin e parë në këtë pjesë, ndërsa argumentet e Mbrojtjes lidhur me NKP-në dhe ndalimin arbitrar do të trajtohen në pjesët vijuese.

¹⁷⁶ *Shih* para. 80-103 më poshtë.

¹⁷⁷ *Shih për shembull* Mocioni i Mbrojtjes, para. 19 (“Nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake kërkohet për herë të parë në këtë çështje të shqyrtojë zbatueshmërinë e të drejtës zakonore ndërkombëtare në rendin juridik të Kosovës, çka është thelbësore për të vlerësuar nëse DHS-ja ka juridiksion mbi format e përgjegjësive penale të NKP-së dhe ndalimit arbitrar [...]”); Kundërpërgjigjja, para. 27 (“Sidoqoftë, siç argumenton Mbrojtja në Mocionin e saj as vepra penale e ‘ndalimit arbitrar’ në konflikt të armatosur jondërkombëtar dhe as përgjegjësia penale sipas NKP-së nuk ishin ‘norma juridikisht detyruese’ apo nuk bënin pjesë në të drejtën zakonore ndërkombëtare në kohën përkatëse të Aktakuzës”), 34 (“Sidoqoftë, ZPS-ja keqinterpretonte Mocionin: Mbrojtja ngre kundërshtime për juridiksionin e DHS-së lidhur me krimin konkret të ndalimit arbitrar në konflikt të armatosur jondërkombëtar dhe formën konkrete të përgjegjësive penale të NKP-së” [theksi në origjinal]).

¹⁷⁸ Mocioni i Mbrojtjes, para 16-18, 20-45, 46-60; Kundërpërgjigjja, para. 17-34, 35-39, 40-48.

81. Duke iu kthyer parashtrimeve të Mbrojtjes, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se argumenti mbi zbatimin e dispozitës ligjore më të favorshme për të akuzuarin dhe kërkesa për referimin në Dhomën e Specializuar të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës janë ngritur për herë të parë në Kundërpërgjigje.¹⁷⁹ Në pajtim me rregullën 76 të Rregullores, kundërpërgjigjja ose pjesë të saj merren në shqyrtim vetëm nëse kanë të bëjnë me çështje të reja që dalin nga përgjigjja. Si rrjedhojë, ky parashtrim rrëzohet *in limine*.

82. Në lidhje me parashtrimin e Mbrojtjes se DHS-ja nuk lejohet të ushtrojë juridiksion mbi krimet që parashihen në të drejtën zakonore ndërkombëtare nëse këto vepra penale nuk janë të përfshira në legjislacionin në fuqi në kohën kur mendohet se janë kryer krimet e pretenduara,¹⁸⁰ Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton se: (i) Ligji, ndonëse është objekt i parimeve dhe garancive të përcaktuara në Kushtetutë, është teksti juridik kryesor që rregullon mandatin dhe funksionimin e DHS-së që pasqyrohet në nenin 3(2) të Ligjit; (ii) korniza ligjore përkatëse e përcaktuar nga ligjvënësit për DHS-në, së pari përfshin të drejtën zakonore ndërkombëtare, së dyti të drejtën e Kosovës vetëm nëse ajo përfshihet shprehimisht në Ligj dhe është në pajtueshmëri me të drejtën zakonore ndërkombëtare; dhe (iii) kategorizimi i një gjykate si vendore, ndërkombëtare, hibride apo ndryshe nuk përcakton kornizën ligjore.¹⁸¹ Mbi këtë bazë është dalë në përfundimin se, ndër të tjera, as Kushtetuta e RSFJ-së dhe as Kodi Penal i RSFJ-së nuk e kufizojnë juridiksionin e DHS-së në mënyrën e sugjeruar nga Mbrojtja.¹⁸²

83. Veç kësaj, vendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës i përdorur nga Mbrojtja, i cili kushtëzon se veprat penale dhe dënimet duhet të parashihen në legjislacion konkret

¹⁷⁹ Kundërpërgjigjja, para 23, 24, 29, 30.

¹⁸⁰ Mocioni i Mbrojtjes, paras 12, 16, 17; Kundërpërgjigjja, para 17, 19, 25-27.

¹⁸¹ *Shih* Thaçi dhe të tjerë. Vendimi për Juridiksionin, paras 89, 98, 99, 101, 102; *shih edhe, mutatis mutandis*, KSC-BC-2018-01, IA001/F00005, Gjykata e Apelit, *Vendim mbi Apelin ndaj "Vendimit mbi Kërkesën për Urdhër drejtuar Prokurorit të Specializuar për Pushimin e Hetimit kundër Driton Lajçit"* (Vendimi mbi Apelin Lajçi), 1 tetor 2021, publik, para. 16.

¹⁸² *Shih* Thaçi dhe të tjerë. Vendimi për Juridiksionin, para. 99.

vendor përkatës, është i dallueshëm. Precedenti në fjalë lindi nga rendi juridik i përkufizuar në Rregulloren e UNMIK-ut 1999/24, e cila përcaktonte, ndër të tjera, se ligji në fuqi më 22 mars 1989 sillte *prima facie* përfshirjen e parimit të ligjshmërisë siç përcaktohet në Kushtetutën e RSFJ-së.¹⁸³ Përkundrazi, Ligji si korniza parësore që rregullon proceset e DHS-së, parasheh konkretisht zbatimin e të drejtës zakonore ndërkombëtare. Mbrojtja nuk e shtjellon argumentin e vet në mënyrë bindëse që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të rishqyrtojë konstatimet e lartpërmendura.

84. Si rezultat, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmon se DHS-ja zbaton të drejtën zakonore ndërkombëtare dhe, përveç Ligjit, nuk është i zbatueshëm asnjë ligj tjetër vendor për DHS-në përveçse kur është i përfshirë në Ligj dhe është në pajtueshmëri me të drejtën zakonore ndërkombëtare. Si rrjedhojë, për arsyet e përmendura më lart, parashtrimi i Mbrojtjes rrëzohet.

85. Në lidhje me pretendimin e Mbrojtjes se neni 3(2)(d) i Ligjit duhet interpretuar në përputhje me parimin e ligjshmërisë,¹⁸⁴ është përcaktuar më parë se përmendja e nenit 7(2) të KEDNJ-së dhe nenit 15(2) të KNDCP-së në nenin 12 të Ligjit duhet interpretuar se ngërthen në tërësi nenin 7 të KEDNJ-së dhe nenin 15 të KNDCP-së në sajë të nenit 3(2)(a) dhe (e) të Ligjit dhe neneve 22 dhe 33 të Kushtetutës.¹⁸⁵ Gjithashtu është konstatuar se duke miratuar legjislacion vendor që përcakton shprehimisht krime ndërkombëtare që ekzistojnë në të drejtën zakonore ndërkombëtare në kohën përkatëse, ligjvënësi mund të lejojë madje edhe të autorizojë ndjekjen penale për një sjellje që ka ndodhur para se të hynte në fuqi penalizimi në të drejtën e kodifikuar vendore pa krijuar probleme në lidhje me prapaveprueshmërisë.¹⁸⁶ Me pretendimin se ky konstatim shpërfill spektrin e gjerë të mbrojtjes të ofruar nga neni 7 i KEDNJ-

¹⁸³ Kosovë, Gjykata Supreme, *Veselin Bešović v. Prosecutor*, AP-KZ NO.80/2004, 7 shtator 2004, f. 18.

¹⁸⁴ Mocioni i Mbrojtjes, para 7, 12-14, 17; Kundërpërgjigja, para. 18-22, 28.

¹⁸⁵ *Shih* Thaçi dhe të tjerë. Vendimi për Juridiksionin, para. 93-95.

¹⁸⁶ *Shih* Thaçi dhe të tjerë. Vendimi për Juridiksionin, para. 101.

së,¹⁸⁷ Mbrojtja keqkupton se disponueshmëria dhe parashikueshmëria janë trajtuar më vete, siç shtjellohet më poshtë,¹⁸⁸

86. Konstatimi më lart gjithashtu është në përputhje me nenin 7(1) të KEDNJ-së. GJEDNJ-ja ka konstatuar se përfshirja e një vepre penale sipas së drejtës ndërkombëtare parasheh se nuk ka shkelje të nenit 7(1) të KEDNJ-së nëse dënimi mbështetet në dispozita ligjore shtetërore që nuk kanë qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, në qoftë se dënimi bazohej ose në të drejtën ndërkombëtare të traktateve apo në të drejtën zakonore ndërkombëtare, sipas rastit, në kohën e kryerjes.¹⁸⁹ Vlen të përmendet në veçanti se GJEDNJ-ja e zbatoi këtë parim në lidhje me një dënim të shqiptuar bazuar në legjislacionin shtetëror të miratuar në vitin 2003 lidhur me një vepër penale sipas të drejtës ndërkombëtare të kryer gjatë konfliktit në ish-Jugosllavi në vitin 1992.¹⁹⁰ Në lidhje me këtë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton më tej se argumenti i parashtruar nga Mbrojtja se GJEDNJ-ja e lejon zbatimin e nenit 7(1) të KEDNJ-së për sjellje të kundërligjshme flagrante është i gabuar. Ndonëse GJEDNJ-ja përmend natyrën e kundërligjshme të sjelljes flagrante në lidhje me parashikueshmërinë,¹⁹¹ ajo nuk nxori konstatimin se neni 7(1) i KEDNJ-së, në përgjithësi zbatohet lidhur me këtë sjellje. Në fakt, përmendja e papërcaktuar e një vepre penale sipas së drejtës ndërkombëtare e përjashton këtë interpretim kufizues.

87. Si rrjedhojë, hidhet poshtë argumenti i Mbrojtjes se neni 3(2)(d) i Ligjit nuk respekton parimin e ligjshmërisë.

¹⁸⁷ Kundërpërgjigjja, para. 28.

¹⁸⁸ *Shih* Thaçi dhe të tjerë. Vendimi për Juridiksionin, para. 103-104.

¹⁸⁹ *Shih* ECtHR, *Vasiliauskas v. Lithuania*, no. 35343/05, [Judgment](#), 20 October 2015, para. 166.

¹⁹⁰ ECtHR, *Šimšić v. Bosnia and Herzegovina* (“*Šimšić v. Bosnia and Herzegovina*”), no. 51552/10, Decision, 10 April 2012, paras 22-25.

¹⁹¹ ECtHR, *Šimšić v. Bosnia and Herzegovina*, para. 24.

88. Së fundi, në lidhje me kornizën e përgjithshme ligjore pas Luftës së Dytë Botërore,¹⁹² ndjekjet penale në vazhdimësi të TPNJ-së në kohën e kryerjes,¹⁹³ traktatet përkatëse ndërkombëtare të ratifikuara nga RSFJ -ja,¹⁹⁴ dhe veprimet e ndaluara me ligj në Kodin Penal të RSFJ-së (disa prej të cilave pasqyrojnë krimet për të cilat ngrihen akuzat),¹⁹⁵ Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se në kohën përkatëse, për të akuzuarin ishte e disponueshme dhe e parashikueshme se përfshirja në sjellje që përbëjnë vepra penale sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare mund të shkaktojë përgjegjësi penale individuale.

89. Në përfundim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rrëzon argumentin në Mocionin e Mbrojtjes se e drejta zakonore ndërkombëtare nuk ka efekt të drejtpërdrejtë në proceset e DHS-së.

2. Ndërmarrja Kriminale e Përbashkët

90. Në lidhje me pretendimin e Mbrojtjes së NKP-ja nuk ishte pjesë e kornizës ligjore shtetërore në kohën e kryerjes së krimeve të pretenduara,¹⁹⁶ Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton konstatimet e tij se: (i) DHS-ja zbaton së pari të drejtën zakonore ndërkombëtare dhe më pas legjislacionin e Kosovës vetëm kur është i përfshirë shprehimisht në ligj dhe është në përputhje me të drejtën zakonore ndërkombëtare;¹⁹⁷ dhe (ii) neni 16(1) i Ligjit nuk përfshin shprehimisht dispozitat e legjislacionit të

¹⁹² IMT Charter (RSFJ-ja aderoi më 29 shtator 1945), Article 6; CCL10, Article II; International Law Commission, Principles of International Law Recognized in the Charter of the Nürnberg Tribunal and the Judgment of the Tribunal, 1950, Principle II.

¹⁹³ Sipas dokumenteve që gjenden në faqen e TPNJ-së në internet, në kohën e ngritjes së akuzave në Aktakuzën e Konfirmuar po zhvilloheshin çështje gjyqësore për disa dhjetëra persona.

¹⁹⁴ Protocol Additional to the Geneva Conventions of 12 August 1949, and relating to the Protection of Victims of Non-International Armed Conflicts (Protocol II), 1125 UNTS 609, 8 June 1977; Convention on the Non-Applicability of Statutory Limitations to War Crimes and Crimes Against Humanity, 754 UNTS 73, 26 November 1968; Convention against Torture and Other Cruel, Inhuman, or Degrading Treatment or Punishment, 1465 UNTS 85, 10 December 1984.

¹⁹⁵ Neni 142 i Kodit Penal të RSFJ-së përmban, për shembull, vrasjen, tortura, trajtim çnjerëzor dhe arrestim dhe ndalim të paligjshëm.

¹⁹⁶ Mocioni i Mbrojtjes, para. 3-4, 21, 25-28; Kundërpërgjigja, para. 22.

¹⁹⁷ *Shih paras.* 82-87 më lart; *shih edhe, mutatis mutandis*, Vendimi mbi Apelin *Lajçi*, para. 16.

Kosovës ndryshe nga paragrafi i dytë dhe i tretë i të njëjtës dispozitë.¹⁹⁸ Nga kjo rrjedh se në lidhje me veprat penale sipas neneve 13-14 të Ligjit, DHS-ja mund të zbatojë format e përgjegjesisë penale që ishin pjesë e të drejtës zakonore ndërkombëtare në kohën e kryerjes së krimeve të pretenduara.¹⁹⁹ Duke pasur parasysh se aktvendimet e Gjykatë së Apelit të Kosovës në lidhje me NKP-në²⁰⁰ u miratuan në përputhje me një kornizë ligjore të ndryshme, jo e bazuar në këtë Ligj, këto aktvendime nuk janë relevante për vendimin konkret. Për këto arsye, argumentet e Mbrojtjes hidhen poshtë.

91. Në lidhje me parashtrimin e Mbrojtjes së në Ligj nuk gjendet bazë ligjore për NKP-në,²⁰¹ Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka konstatuar më parë se neni 16(1) i Ligjit duke përfshirë edhe kuptimin që i ka dhënë “kryerjes”, duhet interpretuar në përputhje me të drejtën zakonore ndërkombëtare që ishte në fuqi në kohën e kryerjes së krimeve të pretenduara duke mbajtur parasysh se: (i) DHS-ja zbaton së pari të drejtën zakonore ndërkombëtare dhe më pas legjislacionin e Kosovës vetëm kur është i përfshirë shprehimisht në ligj dhe është në përputhje me të drejtën zakonore ndërkombëtare; (ii) nenet 13-14 të Ligjit i referohen konkretisht të drejtës zakonore ndërkombëtare si e drejta e zbatueshme për krime kundër njerëzimit dhe krime lufte gjatë juridiksionit kohor të DHS-së; dhe (iii) terminologjia e përdorur në nenin 16(1)(a) të Ligjit është praktikisht e njëjtë me dispozitat që rregullojnë format e përgjegjesisë penale në statutet e TPNJ-së dhe TPNR-së, të cilët kanë zbatuar forma të përgjegjesisë penale nga e drejta zakonore ndërkombëtare.²⁰² Kjo do të thotë më tej se, meqenëse NKP-ja ishte më se e përcaktuar në të drejtën penale ndërkombëtare në kohën kur u miratua Ligji, përfshirja e një përkufizimi thuajse të njëjtë për format e përgjegjesisë penale në Ligj nuk demonstron, sikurse pretendon Mbrojtja,²⁰³ se ligjvënësit synonin

¹⁹⁸ *Shih* Thaçi dhe të tjerë. Vendimi për Juridiksionin, para. 178.

¹⁹⁹ *Shih* Thaçi dhe të tjerë. Vendimi për Juridiksionin, para. 179.

²⁰⁰ Mocioni i Mbrojtjes, para. 28.

²⁰¹ Mocioni i Mbrojtjes, para. 21, 29-32; Kundërpërgjigja, para. 41-42.

²⁰² *Shih* Thaçi dhe të tjerë. Vendimi për Juridiksionin, para. 177.

²⁰³ Mocioni i Mbrojtjes, para. 31.

të përjashtonin NKP-në, por përkundrazi mbështet sugjerimin se ata në fakt synonin konkretisht të përfshinin këtë formë të përgjegjesisë penale. Ky interpretim bazohet në tekstin e nenit 16(1) të Ligjit, interpretuar sipas kontekstit të vet dhe të drejtës zakonore ndërkombëtare të zbatueshme. Si rrjedhojë, nuk mund të pretendohet se ky interpretim bie ndesh me nenin 33 të Kushtetutës dhe nenin 7(1) të KEDNJ-së.²⁰⁴ Rrjedhimisht, argumentet e Mbrojtjes hidhen poshtë.

92. Në lidhje me parashtrimet e Mbrojtjes se NKP-ja, në përgjithësi, nuk ishte e përcaktuar në të drejtën zakonore ndërkombëtare në vitin 1999,²⁰⁵ Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka shtjelluar më parë se duke marrë parasysh jurisprudencën përputhëse nga tribunalët ndërkombëtarë bashkëkohorë sipas nenit 3(3) të Ligjit, nuk ka arsye bindëse për të devijuar prej konstatimit se NKP I është e përcaktuar në të drejtën zakonore ndërkombëtare.²⁰⁶ Mbrojtja përmend një publikim të një ish-gjykatësi të TPNJ-së,²⁰⁷ por ky publikim në vetvete nuk mjafton për të rishikuar jurisprudencën e dalë prej vendimeve të tribunalëve ndërkombëtarë.²⁰⁸ Mbrojtja nuk arrin të provojë parashtrimin e saj i cili për rrjedhojë rrëzohet.

93. Në mënyrë të ngjashme, shumica e argumenteve të Mbrojtjes në mbështetje të parashtrimit të saj se NKP III nuk përbën formë të përgjegjesisë penale sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare²⁰⁹ janë shqyrtuar më parë dhe janë rrëzuar. Më konkretisht, është nxjerrë përfundimi se: (i) nuk ka asnjë arsye bindëse për të devijuar sipas jurisprudencës së DHJGJK, nga jurisprudenca e gjykatave dhe tribunalëve të ndryshëm ndërkombëtarë e të ndërkombëtarizuar se NKP III është pjesë e të drejtës zakonore ndërkombëtare; (ii) qasja e reflektuar në Statutin e GJPN-së nuk ka lidhje me aspektin nëse NKP III është pjesë e të drejtës zakonore ndërkombëtare, pasi shtetet në

²⁰⁴ Mocioni i Mbrojtjes, para. 32.

²⁰⁵ Mocioni i Mbrojtjes, para. 3-4, 21, 33-35, 43; Kundërpërgjigjja, para. 43-44.

²⁰⁶ *Shih* Thaçi dhe të tjerë. Vendimi për Juridiksionin, para. 181-185, 187.

²⁰⁷ Mocioni i Mbrojtjes, para. 35, poshtëshënim 56; Kundërpërgjigjja, para. 46.

²⁰⁸ *Shih* Thaçi dhe të tjerë. Vendimi për Juridiksionin, para. 188.

²⁰⁹ Mocioni i Mbrojtjes, para. 3-4, 21, 36-42; Kundërpërgjigjja, para. 47-48.

fjalë nuk u përpoqën të kodifikonin të drejtën zakonore ndërkombëtare kur miratuan Statutin e Romës; (iii) publikimet e (ish) gjykatësve dhe akademikëve që mbështetin zhvillime të ndryshme të Ligjit apo që paraqesin opinionet e tyre personale për tema të ndryshme nuk mund të hedhin poshtë jurisprudencën e dalë prej vendimeve të tribunalëve ndërkombëtarë; dhe (iv) precedenti i Gjykatës Supreme të Britanisë së Madhe që hodhi poshtë jurisprudencën e vet lidhur me ndërmarrjen kriminale të përbashkët ka lidhje me një vepër penale sipas juridiksionit vendor e përfshirë në akuzë sipas një përgjegjësie penale dytësore në bazë të së drejtës vendore dhe nuk ndikon në përcaktimin e të drejtës zakonore ndërkombëtare në lidhje me krimet ndërkombëtare.²¹⁰ Në lidhje me mbështetjen e Mbrojtjes në jurisprudencën e TSL-së dhe GJSSL-së për zbatimin e NKP III ndaj krimeve me synim konkret, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vlerëson se për rrethanat e çështjes konkrete nuk është nevoja të trajtohen këto argumente. Arsyeja është se z. Shala nuk akuzohet për torturë e cila është e vetmja vepër penale e pretenduar për të cilën kërkohet synimi konkret në përputhje me NKP III.²¹¹ Si rrjedhojë, parashtrimet e Mbrojtjes nuk duhen marrë parasysh.

94. Veç kësaj, pretendimi i Mbrojtjes se NKP III është në kundërshtim të qartë me parimin e fajësisë individuale²¹² sikurse dhe është përcaktuar më parë, nuk është tërësisht juridiksional.²¹³ Gjithsesi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton se është konstatuar se pjesëmarrja e qëllimshme dhe kontributi i qenësishëm në një qëllim të përbashkët, së bashku me kriteret se duhej të kishte qenë e parashikueshme për këtë person se mund të ndodhte një krim jashtë kuadrit të këtij qëllimi të përbashkët dhe

²¹⁰ *Shih* Thaçi dhe të tjerë. Vendimi për Juridiksionin, para. 186-188.

²¹¹ Aktakuza e Konfirmuar, para. 8-9, ku parashtrahet se z. Shala kishte të njëjtin synim për kryerjen e krimeve që akuzohet (ndalim arbitrar, trajtim çnjerëzor, torturë dhe vrasje) me anëtarët e tjerë të NKP-së, ose ishte e parashikueshme për të se krimi i vrasjes së paligjshme mund të kryhej nga një ose më shumë anëtarë të NKP-së, ose nga persona të përdorur nga cilido prej anëtarëve të NKP-së për kryerjen e krimeve të përfshira në qëllimin e përbashkët dhe se e mori përsipër rrezikun me vullnet të lirë.

²¹² Mocioni i Mbrojtjes, para. 24; Kundërpërgjigja, para. 45.

²¹³ *Shih* Thaçi dhe të tjerë. Vendimi për Juridiksionin, para. 202-203.

se fakti se i akuzuari e mori përsipër këtë rrezik me vullnet të lirë, përbën përgjegjësi penale në përputhje me NKP III.²¹⁴ Për rrjedhojë, argumenti i Mbrojtjes është i pabazë.

95. Në lidhje me disponueshmërinë dhe parashikueshmërinë e NKP-së,²¹⁵ rikujtojmë se: (i) aktgjykimi i parë i TPNJ-së që mori parasysh përgjegjësinë penale për pjesëmarrje në NKP ishte ai i dhjetorit 1998 në çështjen *Prokurori k. Anto Furunxhisë*; (ii) kuadri i përgjithshëm ligjor për NKP-në u zhvillua pas Luftës së Dytë Botërore; dhe (iii) nenet 22 dhe 26 të Kodit Penal të RSFJ-së pasqyrojnë konceptin e përgjegjësisë penale të përbashkët.²¹⁶ Këta konstatime nuk përmbajnë hamendësime dhe të marra së bashku me konstatimin se NKP-ja ishte pjesë e të drejtës zakonore ndërkombëtare në kohën përkatëse, demonstrojnë se kryerja e krimeve mbi bazën e NKP-së është qartësisht e paligjshme.²¹⁷ Në lidhje me sa më sipër, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se si NKP I po ashtu dhe NKP III ishin të parashikueshme dhe të disponueshme për të akuzuarin në kohën e kryerjes së krimeve të pretenduara. Si rrjedhojë parashtrimet e Mbrojtjes hidhen poshtë.

96. Së fundi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i referohet pretendimit të Mbrojtjes se mbështetja në NKP nuk është vetëm e paligjshme por edhe e papërshtatshme pasi z. Shala akuzohet se ka kryer në mënyrë të drejtpërdrejtë krimet e përfshira në Aktakuzën e Konfirmuar.²¹⁸ I takon Prokurorit të Specializuar në ushtrimin e kompetencës së tij diskrecionale që të vlerësojë nëse një person duhet akuzuar bazuar në një formë konkrete të përgjegjësisë penale.²¹⁹ Detyra e gjykatësve të trupit gjykues është të përcaktojnë nëse provat çojnë në shpallje të fajësisë bazuar në këtë formë të përgjegjësisë penale. Rrjedhimisht, ky pretendim nuk përbën kundërshtim juridiksional. Lidhur me pretendimin e Mbrojtjes se NKP-ja mund të përdoret si bazë

²¹⁴ *Shih* Thaçi dhe të tjerë. Vendimi për Juridiksionin, para. 206.

²¹⁵ Mocioni i Mbrojtjes, para. 44-45.

²¹⁶ *Shih* Thaçi dhe të tjerë. Vendimi për Juridiksionin, para. 194-200.

²¹⁷ Kundërpërgjigja, para. 22, 27, 32, 34.

²¹⁸ Mocioni i Mbrojtjes, para. 23.

²¹⁹ *Shih edhe* KSC-BC-2020-04, F00003, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër Prokurorit të Specializuar në pajtim me rregullën 86(4) të Rregullores*, 28 shkurt 2020, publik, para. 10.

ligjore vetëm për të trajtuar përgjegjësinë e udhëheqësve, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vlerëson se argumentet lidhur me elementet përbërëse të formës së përgjegjësisë penale nuk janë juridiksionalë.²²⁰ Sidoqoftë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se nuk ka asnjë pengesë ligjore për zbatimin e përgjegjësisë për NKP për personat që nuk kanë pozita udhëheqëse. Elementet objektive të NKP-së si numri i personave, plani, projekti apo qëllimi i përbashkët përbën ose përfshin kryerjen e krimit të paraparë në Ligj dhe pjesëmarrja e të akuzuarit në realizimin e planit, projektit dhe qëllimit të përbashkët nuk pasqyron një kufizim të tillë. Krahas kësaj, Dhoma e Apelit e TPNJ-së ka konfirmuar shprehimisht se NKP-ja është zbatuar në çështje ku anëtarët e NKP-së ishin (ndër) kryesit kryesorë si dhe në çështje të një shkalle relativisht më të ulët.²²¹ Për këto arsye, argumentet e Mbrojtjes hidhen poshtë.

97. Duke marrë parasysh sa më lart, hidhet poshtë argumenti në Mocionin e Mbrojtjes se DHS-ja nuk ka juridiksion ndaj NKP-së.

3. Ndalimi arbitrar

98. Sa i takon pretendimit të Mbrojtjes lidhur me statusin e krimit të ndalimit arbitrar sipas legjislacionit shtetëror në fuqi,²²² Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton konstatimet e tij se në gjykimin e krimeve të përmendura në nenet 13 dhe 14 të Ligjit, që pretendohet të jenë kryer brenda juridiksionit kohor të saj, DHS-ja zbaton të drejtën zakonore ndërkombëtare të parën dhe legjislacionin e Kosovës vetëm në raste kur është përfshirë shprehimisht në Ligj dhe është në përputhje me të drejtën zakonore ndërkombëtare.²²³ Kjo do të thotë që vlerësimi nëse ndalimi arbitrar përbënte apo jo krim lufte në një konflikt të armatosur jondërkombëtar gjatë kuadrit kohor të

²²⁰ Ngjashëm Thaçi dhe të tjerë. Vendimi për Juridiksionin, para. 175.

²²¹ TPNJ, *Prosecutor v. Brđanin*, IT-99-36-A, Appeals Chamber, [Judgment](#), 3 April 2007, paras 406, 425.

²²² Mocioni i Mbrojtjes, para. 3-4, 48-50.

²²³ *Shih para.* 82-87 më lart; *shih gjithashtu, mutatis mutandis*, Vendimi mbi Apelin Lajçi, para. 16.

Aktakuzës së Konfirmuar, bëhet në kontekstin e të drejtës zakonore ndërkombëtare. Për këtë arsye, parashtrimet e Mbrojtjes rrëzohen.

99. Në lidhje me pretendimin e Mbrojtjes se ndalimi arbitrar nuk është i përfshirë në nenin 14(1)(c) të Ligjit,²²⁴ Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton se më parë është konstatuar se formulimet e përdorura, nga një anë në paragrafin (1)(a) dhe (c) dhe, nga ana tjetër, në paragrafin (1)(b) dhe (d) të së njëjtës dispozitë kanë kuptim të ngjashëm joshterues.²²⁵ Veç kësaj, ndryshe nga pretendimi i Mbrojtjes,²²⁶ Neni i Përbashkët 3 nuk është shterues duke marrë parasysh se fjalia e tij hyrëse parasheh që çdo palë në një konflikt duhet të zbatojë *më së paku* dispozitat e mëposhtme. Kjo nënkupton se krimet e luftës që janë pjesë e juridiksionit të DHS-së nuk janë domosdoshmërisht vetëm ato të renditura shprehimisht në nenin 14 të Ligjit me kusht që një krim i tillë duhet të ketë ekzistuar në të drejtën zakonore ndërkombëtare në kohën e kryerjes së tij të pretenduar në pajtim me nenet 3(2)(d) dhe 12 të Ligjit.²²⁷ Si rrjedhojë, parashtrimet e Mbrojtjes duhet të rrëzohen.

100. Veç kësaj, rikujtojmë se ndryshe nga argumentet e Mbrojtjes,²²⁸ është konstatuar se ndalimi arbitrar përbën shkelje të rëndë të Nenit të Përbashkët 3.²²⁹ Më konkretisht, në kontekstin e ndalimit nga një aktor joshitetëror në konflikt të armatosur ndërkombëtar, ndalimi arbitrar nënkupton heqje të lirisë: (i) pa bazë të vlefshme ligjore – duke marrë parasysh mungesën e një baze për ndalimin në të drejtën humanitare ndërkombëtare të traktateve, ose të drejtën humanitare ndërkombëtare zakonore në lidhje me konflikte të armatosur jondërkombëtare; ose (ii) në shkelje të garancive procedurale bazë, në kuadër të fushëveprimit të gjerë të përcaktuar në Nenin e Përbashkët 3 për trajtimin njerëzor.²³⁰ Sipas Gjykatësit të Procedurës

²²⁴ Mocioni i Mbrojtjes, paras 3-4, 47, 51; Kundërpërgjigjja, paras 35-36.

²²⁵ *Shih* Thaçi dhe të tjerë. Vendimi për Juridiksionin, para. 144.

²²⁶ Kundërpërgjigjja, para. 36.

²²⁷ *Shih edhe* Thaçi dhe të tjerë. Vendimi për Juridiksionin, para. 145.

²²⁸ Mocioni i Mbrojtjes, paras 3-4, 47, 52-54.

²²⁹ *Shih* Thaçi dhe të tjerë. Vendimi për Juridiksionin, para. 156.

²³⁰ *Shih* Thaçi dhe të tjerë. Vendimi për Juridiksionin, para. 149-155.

Paraprake, konstatimi se në këto rrethana konkrete ndalimi arbitrar përbën shkelje të rëndë të Nenit të Përbashkët 3 është pasqyruar fuqimisht në formulimin e kësaj dispozite, që përbën të drejtë zakonore ndërkombëtare në tërësinë e vet.²³¹ Si rezultat, mbështetja prej Mbrojtjes të diskutimet aktuale mbi aspektet e ndryshme të heqjes së lirisë në një konflikt të armatosur jondërkombëtar nuk ndryshon këto konstatime.²³² Po ashtu, pretendimi i Mbrojtjes se heqja e lirisë përbën në parim një dukuri të ligjshme në të drejtën humanitare ndërkombëtare²³³, pa aspekte të tjera, nuk eliminon mundësinë që ndalimi të konsiderohet arbitrar në raste të caktuara. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vlerëson më tej se argumenti i Mbrojtjes se Vendimi i Konfirmimit ngatërron ndalimin arbitrar me trajtimin çnjerëzor²³⁴ është i gabuar. Kushtet e ndalimit përbëjnë një çështje më vete që mund të lidhet ose të përbëjë krime të tjera në juridiksionin e DHS-së.²³⁵ Si rrjedhojë, argumentet e Mbrojtjes nuk merren parasysh.

101. Në lidhje me parashtrimin e Mbrojtjes së ndalimi arbitrar nuk ishte i ndaluar në të drejtën zakonore ndërkombëtare në vitin 1999,²³⁶ Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka shpjeguar më parë praktikën shtetërore dhe *opinio juris*, e cila përfshin pjesë të legjislacionit shtetëror dhe shprehjen e qëndrimit sovran përmes organizatave ndërkombëtare se, qoftë me përmendjen shprehimisht të konfliktit të armatosur jondërkombëtar, apo pa bërë dallimin ndërmjet llojit të konfliktit të armatosur konkret, përcakton një rregull në të drejtën zakonore ndërkombëtare që penalizon ndalimin arbitrar në konflikt të armatosur ndërkombëtar.²³⁷ Në këtë drejtim është

²³¹ *Shih për shembull* ICJ, [Case Concerning Military and Paramilitary Activities in and against Nicaragua \(Nicaragua v. United States\)](#), I.C.J. Reports 1986 (p. 14), Judgment, 27 June 1986, para. 218; [Tadić Interlocutory Appeal Decision](#), para. 98.

²³² Mocioni i Mbrojtjes, para. 53.

²³³ Mocioni i Mbrojtjes, para. 53.

²³⁴ Mocioni i Mbrojtjes, para. 54.

²³⁵ Në Aktakuzën e Konfirmuar, pretendohet se si rezultat i kushteve në të cilat u mbajtën personat në kuadrin kohor përkatës, z. Shala mban përgjegjësi penale për krimet e luftës së trajtimit çnjerëzor dhe/ose torturës; *shih* Aktakuza e Konfirmuar, para. 18, 26.

²³⁶ Mocioni i Mbrojtjes, para. 3-4, 47, 55-59; Kundërpërgjigja, para. 38.

²³⁷ *Shih* Thaçi dhe të tjerë. Vendimi për Juridiksionin, paras 159-164.

shpjeguar më parë se, ndryshe nga argumenti i Mbrojtjes se Gjykatësi i Procedurës Paraprake është mbështetur pothuajse tërësisht në Studimin e KNKK-së,²³⁸ KNKK-ja në vetvete nuk prodhon apo kristalizon praktika shtetërore, por së bashku me aktorë të tjerë, KNKK-ja është një burim autentik për praktika shtetërore që Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka të drejtë ta shqyrtojë në mënyrë të pavarur.²³⁹ Në lidhje me këtë, pretendimi i Mbrojtjes se Studimi i KNKK-së u jep rëndësi të tepruar materialeve me shkrim²⁴⁰ mbështetet në një burim që nuk e ngre këtë kundërshtim shprehimisht në lidhje me ndalimin arbitrar, e sidoqoftë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, bazuar në metodologjinë e pranuar për përcaktimin e një rregulle të së drejtës zakonore ndërkombëtare, ka konfirmuar në mënyrë të pavarur se ekziston rregulla e së drejtës zakonore ndërkombëtare për penalizimin e ndalimit arbitrar. Gjithashtu, sa u takon pretendimeve të Mbrojtjes se disa nga kodet penale të përmendura në Studimin e KNKK-së u miratuan pas vitit 1999, është vlerësuar më parë se mbështetja në burime të tilla është e pranueshme në disa raste si një mjet dytësor, për të treguar zhvillimin e vazhdueshëm (përkundrejt praktikës së kundërt me të) të një rregulle zakonore që ndërkohë ekzistonte në kohën përkatëse.²⁴¹ Si rrjedhojë, parashtrimet e Mbrojtjes rrëzohen.

102. Së fundi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vlerëson se duke pasur parasysh penalizimin e heqjes arbitrarë të lirisë në ish-Jugosllavi (dhe më gjerë) dhe dënimin e një sjelljeje të tillë nga OKB-ja në lidhje me konfliktet në ish-Jugosllavi, ishte e disponueshme dhe e parashikueshme për të akuzuarin se në kohën përkatëse, përfshirja në veprime të ndalimit arbitrar mund të shkaktonte përgjegjësi penale individuale.²⁴² Në ndryshim nga parashtrimet e Mbrojtjes,²⁴³ këto konstatime nuk bazohen në supozime apo përmendje të përgjithshme të krimeve të luftës në Kodin

²³⁸ Mocioni i Mbrojtjes, para. 55.

²³⁹ *Shih* Thaçi dhe të tjerë. Vendimi për Juridiksionin, para. 157.

²⁴⁰ Mocioni i Mbrojtjes, para. 57 dhe poshtëshënimi 96.

²⁴¹ *Shih* Thaçi dhe të tjerë. Vendimi për Juridiksionin, para. 158.

²⁴² *Ngjashëm* Thaçi dhe të tjerë. Vendimi për Juridiksionin, para. 165.

²⁴³ Mocioni i Mbrojtjes, para. 60; Kundërpërgjigja, para. 32, 33, 39.

Penal të RSFJ-së. Për më tepër, të marra së bashku me konstatimin se ndalimi arbitrar ishte pjesë e të drejtës zakonore ndërkombëtare në kohën përkatëse, këto konstatime demonstrojnë edhe më shumë se veprimet e ndalimit arbitrar ishin qartazi të paligjshme në kohën përkatëse. Nga kjo rrjedh se argumentet e Mbrojtjes nuk qëndrojnë.

103. Në përfundim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rrëzon pretendimin e Mbrojtjes në Mocionin e saj se DHS-ja nuk ka juridiksion ndaj ndalimit arbitrar si krim lufte në KAJN në pajtim me nenin 14(1)(c) të Ligjit.

V. VENDIM

104. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- (a) **RRËZON** kundërshtimet lidhur me themelimin e DHS-së dhe/ose pretendimin se janë shkelur të drejtat e të akuzuarit sipas nenit 39(1) të Ligjit, në Mocionin e Mbrojtjes; dhe
- (b) **RRËZON** kundërshtimet lidhur juridiksionin e DHS-së bazuar në rregullën 97(1)(a) të Rregullores, në Mocionin e Mbrojtjes.

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju
Gjykatës i Procedurës Paraprake

E hënë, 18 tetor 2021

Në Hagë, Holandë.